

**AHMET
GOLEMI**

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

961

Humbja e parë

TREGIME

814-32

261

AHMET GOLEMI

R

HUMBJA
E
PARE

(TREGIME)

87595
MBL. QIKVA E SHËTETIT
GJ. KOSOVËR

34180

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

HUMBJA E PARË

Për atë që ndodhi kishte kohë që më brente ndër-gjegjja, ndaj prisja rastin që t'ja tregoja dikujt për t'u lehtësuar nga ky kujtim i hidhur, por dhe i bukur i karrierës sportive. Për këtë mora frymë thellë, ashtu siç bënim kur binte gongu për të filluar raundin e tretë dhe më të vështirin, dhe nisa t'i tregoj shokut tim.

Kam hipur në dhjetra tapete. Jam përqafuar, me dëshirë dhe pa dëshirë, me dhjetëra e dhjetëra kundërshtarë. Në pistën e emocioneve kam shkelur për gjashtëmbëdhjetë vjet rresht, dhe kam dalë prej saj, në më të shumtat e rasteve, i shoqëruar nga duartrokitjet. Por kujtimi që më ka rënduar më shumë është ai që provova në ndeshjen me nxënësin tim. Unë e humba ndeshjen me të. Kjo për mua ka qenë humbja e parë dhe e fundit, pasi, kur provon një humbje të tillë, nuk dëshiron që ajo të përsëritet kurrë më.

Unë mburresha me të, sepse si njeri dhe si sportist nuk e kishte shokun. Atë e duartrokisnin shpesh sportdashësit për aftësitë e tij si mundës. Unë i kam qëndruar përherë pranë suksesit dhe mossuksesit të tij. E shikoja kur, pasi hiqte nga shpatullat rripat e kostumit sportiv, fshinte me gëzim djersët. Por e kam parë duke fshirë edhe lotët. Ai qe i tillë. Nga sedra e

tij djersinte dhe nxirrte lot. Dhe atë pasdite, që e rrihte një fillad i freskët prilli, ai u ngjit në tapetin e qytetit N. për t'u ndeshur, në finale, me kundërshtarin e tij dinamovit. Gongu ra. Nxënësi im që i kujdesshëm. Ai qëndronte para kundërshtarit si një zog. Kur i sulej kundërshtari, ai largohej, i matur, po kur i afrohej vetë kundërshtarit, i bënte sportdashësit të entuziazmoheshin dhe ata s'kurseheshin që t'i jepnin kurajo. Ai për ta kishte një forcë magnetike, për kapjet e pastëra e të shkathëta, për zotësinë e manovrimit dhe për zgjuarësinë e tij sportive në tapet, të cilat e bënin të dallohej nga të tjerët. Qëndrimin e tij në tapet e shoqëroja me vështimin tim. Tek ai shikoja një pjesë të vetëvetes. Shpesh kam menduar se mundja është një pjesë e shkruar dobët, por kur e luajnë njerëz të aftë, ajo të emocionon dhe të bën për vete. Një cilësi të tillë kishte dhe nxënësi im. Raundi i parë mbaroi. Ai erdhi dhe ndenji në qoshen, pranë së cilës rrija unë. E freskova dhe i kujtova se kishte të bënte me një kundërshtar të fortë. E pranoi në heshtje. Gongu ra përsëri. Tapeti mori prapë pamjen e një arene, nga e cila njëri nga kundërshtarët do të dilte fitimtar. Tani të dy qëndronin përballë njëri-tjetrit dhe prisnin rastin për të sulmuar. Ovationet në këtë raund ishin të forta për të dy. Nxënësi im detyrohej disa herë të mbrohej me vështirësi nga sulmet plot energji të kundërshtarit. Ishte një raund me karakteristika burrërore. Nga goja e spektatorëve dëgjohej më tepër dhe më shpesh emri i nxënësit tim. Isha emocionuar shumë. Në lëvizjet dhe kapjet e nxënësit tim vura re pak nervozizëm, që i pakësonte kujdesin për t'u mbrojtur. Ja, ai ndërhynte shumë shpejt midis krahëve të kundërshtarit dhe, pasi e mbërthen fort për beli, e ngre lart dhe, duke u përkulur edhe vetë ndër gjunjë,

e përplas për tapet. Në çast kundërshtari bie në pozicionin gjysmë-urë dhe shpejt kthehet brinjas. Ndërkaq nxënësi im, duke dashur ta shfrytëzojë mirë këtë avantazh, i rënë dhe ai në gjunjë, përpiqet ta kthejë përsëri kundërshtarin në pozicionin «urë». Tani spektatorët janë ngritur në këmbë dhe thërresin me të madhe. Por kundërshtari ngrihet pak dhe, sa hap e mbyll sytë, nxënësi im ra me shpatulla në tapet. . . Kundërveprimi i kundërshtarit në kapjen për qafe qe aq i shpejtë, saqë gjyqtari i tapetit nuk e vuri re mirë kapjen e rregullt të mundësit dinamovit. Në mendjen e gjyqtarit kjo kapje u fiksua si e parregullt dhe, pasi e qortoi mundësin dinamovit për kapjen e palejueshme, i fryu bilibilit për vazhdimin e ndeshjes.

Unë e pashë fare mirë këtë kapje dhe isha unë që e vura re i pari gabimin e gjyqtarit të tapetit. Në fillim mendova se unë vetëm e vura re këtë gabim. Por isha gabuar. Ndërkohë tranieri i mundësit dinamovit i qe afruar kryegjyqtarit dhe, nga mënyra e të folurit, dukej se po kërkonte të drejtën e mundësit të tij. U dëgjua gongu. Ndeshja u ndërpre para kohe. Kryegjyqtari hoqi gjyslykët dhe ju drejtua tapetit. Spektatorët, si një dallgë që përplasen në breg, i ndërpre në të bërtiturat. Një heshtje e papritur ra mbi parkun sportiv ku zhvillohej kampionati. Kryegjyqtari qëndroi para të dy mundësve dhe e pyeti nxënësin tim.

— Halit! Ti re nga kapja «për qafe me të dy krahet», apo nga kapja «krahqafë?»

Heshtje. Të gjithë i kishin drejtuar vështrimet nga nxënësi im dhe dukej se ato kishin ngjashmëri me pyetjen e kryegjyqtarit. Nxënësi im u kthye nga unë. Çaste të vështira për të dy. Në qoftë se vërtetohet se nxënësi im kishte rënë me shpatulla nga kapja

«krahqafë», atëhere humbiste ndeshjen, sepse kjo kapje qe e rregullt dhe ndeshjen e fitonte kundërshtari. Po, në qoftë se mundësi rrëzohej nga kapja «për qafe me të dy krahët», atëhere ndeshja vazhdonte, sepse kjo kapje, sipas rregullores, është e parregullt. Vështrimi i tij pyetës u ndesh me lëvizjen mohuese të dorës sime, që mbuloi për një çast ndërgjegjen e pastër të nxënësit tim. Ai kuptoi gjithshka. Për të kjo do të thoshte: «Mos trego». Ai uli kokën. Lëvizja e dorës sime e shqetësoi më tepër nga pyetja e kryegjyqtarit. Por e përmblodhi veten dhe, si për t'i shpëtuar diçkaje, foli shumë shpejt:

— Rrashë nga kapja «krahqafë».

Gjyqtari i tapetit qe i pari që u habit. Unë mbeta. Përgjegjja e nxënësit tim më hutoi. M'u bë se çdo germë e përgjegjes së tij u shndërrua në kapje. Në gjitha kapjet po i merrte në një vend të pambuluar mirë dhe më dukej se isha unë ai që u shemb pak më parë në tapet dhe jo nxënësi im. I ktheva shpinën tapetit dhe eca rëndë drejt mundësve të mi.

— Të pregatitet për ndeshje kush e ka radhën, — thashë me zë të lartë. Asnjë nuk lëvizi. Ndërkaq u dëgjuan ca duartrokitje, si ca pushkë të shkrehura larg. Dukej se kryegjyqtari i kishte dhënë urdhër gjyqtarit të tapetit për t'i dhënë fitoren mundësit dinamovit sipas rregullores. U dëgjuan dhe ca britmat tërë nervozizëm. Këto duhej të qenë britmat e spektatorëve që se njihnin mirë rregulloren. Unë urdhërova përsëri dhe me zë më të fortë:

— Të pregatitet kush e ka radhën për të dalë në ndeshje.

Ai që kishte radhën u ngrit ngadalë. Para tyre, me kokë ulur, qëndronte Haliti, që sapo kishte ardhur nga tapeti.

Tani heshtja e tij më sëmbonte përbrenda. Më dukej se më thoshte me zë të ulët:

«Pse u solle kështu?»

Oh, sa më mundonte qëndrimi i tij! Unë e dija se dhe ai në këto çaste vuante. Ai ishte një nga ata njerëz me zemër të ndjeshme që gëzimi dhe hidhërimi i tjetrit ishte sadopak dhe gëzimi dhe hidhërimi i tij. Ju afrova dhe nisa t'i zgjidh bandazhin me të cilin kishte lidhur kyçin e dorës. Gishtërinjtë dridheshin lehtë dhe me lëvizje të pavetëdishme lironin bandazhin. E kisha të vështirë të përçëndroheshja dhe herë-herë ngrija kokën të shikoja dy mundësit e tjetër që sapo kishin nisur ndeshjen. Loja e tyre më dukej si një film i xhiruar pa zë.

«Ti s'duhej ta bëje këtë, jo, ti s'duhej ta bëje. . .» më dukej se më thoshte nxënësi im.

«Doja që ti ta fitoje ndeshjen, që ekipi ynë të dilte në vend të parë. . .»

«Sido që të ishte, ti duhet ta dish më mirë se unë se, pas një fitoreje të rreme, vjen një humbje e vërtetë».

«Ashtu, po unë isha ohënë i tëri pas ndeshjes dhe doja që ti të fitoje, që të gëzoheshin të gjithë. . . Oh, ndoshta ti s'e kupton këtë, po kjo ka të bëjë me pasionin, me dëshirën e zjarrtë të trainerit, që nxënësi i tij ta kurorëzojë punën e tij me sukses. Po hajde, kjo ndodhi, dhe s'duhet të përsëritet më».

Sapo i kisha hequr bandazhin, kur ra gongu për mbarimin e raundit të parë të ndeshjes që po zhvillohej. Instiktivisht ktheva kokën andej. Tani të dy mundësit e kishin ndërprerë luftimin dhe po drejtoheshin nga trainerët për t'u freskuar e për të dëgjuar këshillat e tyre. Kur ktheva kokën përsëri, vura re se Haliti «e kishte dëgjuar fare rënjen e gongut. Ai

vazhdonte të qëndronte i heshtur, me vështrimin e ngulur te bandazhi që tani e mbante ai ndër duar, si të donte të thoshte:

«Ta mbledh, apo mos ta mbledh».

Qëndrimi i nxënësit tim më të mirë kishte dome-
thënjen e tij. Me të ai donte t'u thoshte shokëve se,
padashur, kishte goditur një njeri me moshë më të
madhe, mësuesin e tij.

Ndër spektatorët zienin pëshpëritjet dhe vësh-
trimet e tyre nuk po i ndaheshin sportistit tim. Atëhe-
re, i shqetësuar, u ngrita nga stoli ku isha ulur dhe
rrëmbimthi i kapa dorën e ja shtrëngova. Me dorën
tjetër i ngrita kokën që i qe varur, dhe i fola:

— Kështu mbaje kokën, se sot ti ke fituar një
ndeshje të madhe.

SHQETËSIMET E PISTËS

Sa herë që ju shikoj, profesor, ju përshëndes dhe matem të ndaloj që t'ju them diçka! Dhe kjo «diçka» nuk është ndonjë gjë e shpikur. Ajo ka ndodhur para syve tuaj dhe ju keni qenë i detyruar të më ndiqni hap pas hapi. Them kështu, se ju e dini që unë kam qenë dhe vrapues. Ju vetë ma diktuat këtë prirje të dytë.

Mprehtësia dhe përvoja juaj zbuluan te unë tiparet e një vrapuesi të mirë. Ju kujtohet atëhere kur bëmë krosin e shkollës? Gjatë vrapimit unë dola i treti dhe ju erdhët dhe më shtrënguat dorën duke më thënë:

«Për mua, ju jeni fituesi!»

Dhe kishit të drejtë. Dy krosët e tjera të shkollës i fitova unë. Po atëhere unë s'isha nxënës i vitit të parë. Më pas ju më afruat në rrethin e atletikës. Madje në vitin e tretë më caktuat dhe përgjegjës të rrethit. Këto s'kanë shumë rëndësi për ju dhe vërtet mund t'ju duken të kota. Tani përsëri ju jeni pedagog dhe, si unë, ju përshëndesin me dhjetëra studentë. Por pra-pë, unë kam diçka për t'ju thënë. Nuk dua t'ju bind, as t'ju përshkruaj thjesht atë që ka ndodhur vite më parë, dhe as t'ju vë faj në lidhje me të. Jo, sinqerisht, jo! Ju e dini që unë u bëra një sportist i mirë në sportin që e kisha më shumë pasion. Dua t'ju tregoj këtë

ngjarje të vogël për t'u shfajësuar ndaj jush, në mënyrë që në mendjen tuaj të mbetem ashtu si përpara ngjarjes që po tregoj. O, profesor, ajo nuk është kushedi se çfarë. Është vetëm një garë, gara nga ato që ju keni parë me qindra. Unë jam i sigurtë se, si atlet i mrekullueshëm që keni qenë, ju ruani shumë shqetësime dhe emocione, disa prej të cilave s'do të bëni keq t'i shkruani, kështu siç po bëj unë. Po, profesor, ajo është vetëm një garë, gara e 5000 metërshit ose, siç e quanim ne «e pesëmijëshit» dhe, që ta keni të qartë, ishte gara e fundit e kupës që po zhvillohej me rastin e festës së ushtrisë. Ishte dita e «10 Korrikut». Viti nuk më kujtohet. Gara zhvillohej në stadiumin «Qemal Stafa» në pushimin e ndeshjes së futbollit: «Partizani» me «17 Nëndorin». Në shkallët e stadiumit s'kishe ku të hidhje mollën nga spektatorët e shumtë. Përpara garës, ndoshta edhe më parë, ju ishit në hall, ose, si i thonë më shkoqur, kishit rënë ngushtë. Gara e pesëmijëshit ishte e fundit dhe vendimtarja për marrjen e kupës. Garat e zhvilluara kishin nxjerrë në krye, me pikë të barabarta, ekipin tonë dhe atë të «Partizanit». Por nuk ishte vetëm ky shkaku i shqetësimit. Çekani ju rrihte në tjetër kudhër. Për këtë garë ishim pregatitur tre atletë: Fotaqi, Ruzhdiu dhe unë, që atëhere isha në vitin e fundit të shkollës. Ju bëtë një gjë të mirë. Një ditë më parë na njoftuat se në garë do të vraponim të tre dhe kjo na bëri të pregatiteshim shpirtërisht. Dhe ashtu ishte. Ne do vraponim të tre, po për klasifikim do të merrte pikë vetëm njëri. Dhe ky «njëri» ishte shqetësimi juaj dhe shqetësimi ynë, pikëpyetja juaj dhe pikëpyetja jonë. Ne ishim tri vështrime që të mundonim para garës, ashtu si na shqetësonte ne vështrimi juaj. Po ta vështronit njërin më gjatë, kjo do të thoshte se ai ishte njeriu që ki-

shit vendosur për ta regjistruar në garë. Çdo njëri nga vështrimet tona donte të thoshte: «Ki besim te unë, profesor!» Ju duhet të shënonit në fletën e garës vetëm njërin nga ne. Dy të tjerët do vraponin «jashtë gare». Kush do të ishte ky «njëri»? Kishim dalë në nxemje. Ju na vështronit si të donit të bindeshit se kush nga ne të tre ndjehej më mirë. Vështrimi ju tradhëtonte. Atëhere e kuptova se ju e kishit vendosur që më parë se kush do të na përfaqësonte, dhe u binda për këtë. Edhe ju ishit të bindur, pasi në protokollin e garës e kishit dhënë emrin e atletit që do të kurronte. Të tre ne ngulmonim për një nxemje të fortë, se të tre kishim besim te vetja. Mua një zë më pëshpëriste përbrenda: «Emrin tënd ka shënuar».

Të tre, gjatë stërvitjeve, kishim shënuar për afërsisht të njëjtin rezultat. Ishim «aty-aty». Po ju s'mund të shënonit në sekretari as Fotaqin e as Ruzhdiun. Të dy ata ishin vrapues prej disa vitesh dhe në grafikun e rezultateve të tyre kishte shumë pak ndryshime. Fotaqi, si më i ri, dukej se akoma s'e kishte thënë fjalën e tij gjer në fund. Po hapi i tij ishte i rëndomtë, si dhe i Ruzhdiut. Një hap me një ritëm monoton, pa nerv. Hapi im qe ndryshe. Vinte më i gjatë, më dinamik dhe shoqërohej e ndihmohej mirë nga krahet. Madje unë isha më i ri në moshë dhe rezultatet e para ishin premtuese.

Një minutë para startimit, ju na thirrët dhe ne shpejtuam e ju erdhëm pranë. Na thatë kalimthi se të tre duhet ta justifikonim veten para spektatorëve të shumtë dhe pastaj m'u drejtuat mua:

«Kam besim, — më thatë me zë ngulmues, — se do ta përballosh me sukses këtë provë të vështirë. Të kesh kujdes ritmikën e hapit sipas grafikut të stërvitjes së fundit».



Të dy shokët e mi i mbërthyen sytë te fytyra juaj, që mundohej të tregohej e qetë, dhe u larguan përnjëherësh gjoja për shkrythur hapin, si të donin të thoshin me këtë:

«Ti bëre tënden, po ne do të bëjmë tonën».

Kur zumë vend te vija e bardhë e startit, i vura vetes dy qëllime: të mundja atletin e «Partizanit» dhe të mos ju turpëroja ju. Nuk e di, po në vetëvete kisha një besim të madh. Ndaj dhe dukesha i qetë. Ju sikur u shqetësuar për këtë tipar timin, pasi kujtuat mos unë nuk e kisha marrë garën me seriozitetin e duhur. Donit të më thoshit diçka, po ndërkohë startieri dha komandën «gati» dhe të gjithë ne, duke u përkulur në gjunjë, i mëshuam fort vijës së bardhë me këpucët tona me thumba. Unë shpejt ngrita dorën lart si të doja të thosha:

«Kot merakoseni, profesor. Do të ndjek hap pas hapi grafikun e stërvitjes së fundit dhe atë që do të më rekomandoni».

Ju ulët kokën dhe, i lehtësuar, u drejtuat për të zënë vend te kthesa e parë e pistës. Ndërkaq shkrepë pistoleta e vogël e startierit dhe të gjithë sulmuan me një frymë korridorin e kuqërremtë të pistës. Me sprintin e parë atleti i «Partizanit» u shkëput nga ne të tjerët dhe priu përpara. Kështu vepronte ai kurdoherë. Dhe kjo kishte të bënte me sedrën dhe me teknikën e hapit të tij. Në sprintin e parë unë nuk e dhashë veten, se nuk doja të pengohesha vetë, as të pengoja ndonjë nga vrapuesit që i kisha fare pranë, në të dy krahët, po gjatë dyqind metrave të para e shtriva hapin mirë, i parakalova të gjithë të tjerët dhe pikërisht, në qoshen e pistës ku qëndronit ju, e arrita kundërshtarin tim. Juve ju pëlqeu kjo, se, duke buzëqeshur, më thatë:

«Kështu po. Mbjaj ritmikën e hapit tënd».

Ndërkaq te shkallët e stadiumit nisën pëshpëritjet. Pjesa e parë e ndeshjes sapo kishte mbaruar dhe spektatorët filluan të jepen pas garës. Kur kaloja para tribunave, ndjeja se pëshpëritjet në atë pjesë të tribunës pushonin. Unë e kuptoja përse ndodhte kjo. Për ta unë isha një debutues i ri. Për sportdashësit e «Partizanit» kjo ishte një e papritur e vogël që të bënte të heshtje, ndërsa për ata të «17 Nëntorit» heshtja tregone diçka më tepër.

Një atleti të ri, me besim në vetëvete e me hap të rregullt, i nevojitet qetësia për të racionalizuar forcat dhe për të ruajtur grafikun e garës që ta këshillon pas çdo xhiroje treneri. E pra, ata sikur i kuptonin të dyja këto. Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Lufta e fortë sportive ndërmjet dyshes sonë dhe grupit që mundohej të na arrinte, e kishte bërë garën më interesante nga ç'mund të pritej. Sportdashësit, sidomos kur dëgjuan spikerin që u bëri të ditur se fitorja e kupës varej pikërisht nga përfundimi i garës sonë, nisën të na inkurajojnë... Unë, profesor, nuk kam për qëllim t'ju përshkruaj garën. Ju atë e keni ndjekur vetë nga fillimi gjer në fund. Dua vetëm t'ju bëj të ditur për ato gjëra, të cilat hedhin dritë më shumë mbi përfundimin e garës.

Ç'është e drejta, pas xhiros së katërt, ju nisët të shqetësoheshit pak. Hapi im nuk e ruante më freskinë, ritmin dhe energjinë e mëparshme. Në xhiron e pestë më thirrët:

«Kujdes hapin!»

Në të gjashtin përsëritët prapë:

«Të lutem, ruaj ritmikën e hapit».

Ju kishit arësye të shprehnit shqetësim. Në fillim të garës e kisha pasur më të lehtë të vrapoja të

dymbëdhjetë xhirot, kurse tani që këmbët më rendnin në pistën e kuqërremtë, që më ndryshe. Kisha menduar se me hapin tim të gjatë dhe ritmik do ta çoja garën gjer në fund. Por s'ishte e thënë të ngjiste ashtu. Atleti i «Partizanit», që vraponte përherë pranë meje, kishte një huq të tijin, që ja kisha vënë re që më parë. Ju, profesor, e mbani mend atë, ashtu zeshkan, me trup të vogël, të shkathët e të shpejtë. . . E pra, ai nuk i duronte konkurentët t'i kishte pranë. Hapi i tyre duhej t'i gjëmonte në veshë, duhej ta trembte. Ndaj vazhdimisht tentonte t'u shkëputej dhe kishte forca ta bënte këtë. Që në xhiron e dytë unë e ndjeva se rrahja e sigurtë e hapit tim prapa tij e mundonte. Kjo më ndillte kënaqësi dhe m'i shtonte shpresat për t'ja kaluar.

«Do të bëjë çmos të më shkëputet, por kjo do t'i sjellë çoroditje të hapit dhe më në fund lodhjen e pashmangshme», thosha me vete dhe prisja nga njëra xhiro te tjetra që ta ulte ritmin e ta ngadalësonte shpejtësinë. «Edhe pak — i jepja kurajo vetes, — dhe duartrokitjet që shoqërojnë dyshen tonë, e cila prin garën, do të më përkasin vetëm mua».

Isha dhënë i tëri pas garës, aq sa, kur pas xhiros së gjashtë ju ngulmonit që të ruaja ritmikën e hapit dhe grafikun e xhirove, mua më dukej sikur s'kishit dhe aq besim te fitorja ime. Ndaj vazhdoja me timen. S'mendoja gjë tjetër, veçse ta mundja kundërshtarin tim psikologjikisht e madje edhe fizikisht. Dhe, duke menduar kështu, kisha harruar që në garë merrnin pjesë dhe atletë të tjerë, që hapi im s'ishte më i vurr nga ju, por nga kundërshtari im, se rendja ime pas tij ishte për të diçka e zakonshme, ndërsa për mua që e provoja për të parën herë, jo e zakonshme. Ajo që më mundon edhe tani kur e kujtoj, ishte se ju

kisha harruar dhe ju, profesor. Më dukej atëhere se ju kishit një rol aq të thjeshtë, sa edhe gjyqtari që, në krye të çdo xhiroje, të thotë edhe sa xhiro të kanë mbetur. Veçse ju, në vend të numrave, përmendnit diçka që kishte lidhje me ritmikën e hapit. Më dukej kështu, se isha i dhënë i tëri pas garës, se më duhej ta kaloja patjetër atletin e «Partizanit» që të gëzohej nga kjo i gjithë ekipi, sportdashësit tanë dhe pasta j të gëzoheshit ju, profesor. Po kjo paska qenë një farë trulllosje e lehtë, që një atlet pa përvojë, siç isha unë, s'mund ta kalonte pa e pësuar. Në xhiron e dhjetë ndjeva se hapit tim i duheshin muskuj të tjerë më të fuqishëm që të kishte mundësi të ndiqte gjer në fund kundërshtarin. Madje ai, sikur ta ndjente krizën time, i vuri kusht vetes që të më shkëputej sa më shumë. Tek e shihja të më largohej, më ngjante me një njeri që mbante në dorë diçka, të cilën e kishte shkëputur nga qenja ime, diçka që kishite të bënte me gëzimin, me entuziazmin e fitores. I etur për të arritur kundërshtarin, ndjeja se vuaja përbrenda që s'do mund ta arrija dot.

Nuk e di profesor, po me mua ndodhte diçka që gjatë garës s'mund ta shpjegoja. Frymëmarrjen e kisha të rregullt sa mund të përballoja dhe disa xhiro të tjera, po hapat jo. E keqja më vinte nga këmbët, që, si të kishin veshur këpucë të rënda, me zor i ngrija dhe po me zor i hidhja përpara. Sa turp më vinte nga sportdashësit, të cilët më shihnin dhe më kuptonin që s'isha në gjendje ta ndiqja dhe ta arrija më atletin e «Partizanit»! Më dukej sikur më thoshin:

«Kur s'qenke i zoti t'i urdhërosh këmbët e tua gjer në fund, pse ja shkele në fillim si çilimi?!»

Kur, në xhiron e njëmbëdhjetë, të kalova pranë

syulur, m'u kujtuan fjalët që më kishe thënë një herë:

«Në garë njeriu tregon veten e tij».

Oh, vërtet të isha tallur me shpresat e mijëra dashamirësve të mi, me gëzimin e shokëve e të shoqeve të ekipit për marrjen e kupës, me mundin e me djersën e tyre dhe me besimin tënd për mua! Jo, kjo s'duhej menduar kurrë. Dhe më e keqja që se, ndërsa në fillim unë kisha menduar vetëm për atletin e «Partizanit», tani duhej të mendoja për të tjerët që po më arrinin.

«Kjo s'duhej të ndodhë», — thashë me vete dhe nuk e di, profesor, po më dukej se xhiron e dymbëdhjetë dhe të fundit duhej ta vrapoja vetëm për ju. «Jo, s'duhet ta turpëroj, — mendoja për ju, — fundja të mbërrij para Fotaqit dhe Ruzhdiut», dhe instinktivisht ktheva kokën prapa: tani atletët e tjerë, të cilët i kisha lënë njëmbëdhjetë xhiro pas, i kishin derdhur energjitë që u kishin mbetur për të më arri-rë. Ishin të dhjetë pranë e pranë dhe mua m'u duk se ata shtynin njëri-tjetrin që të më arrinin sa më shpejt. Isha i lodhur dhe në atë çast ata m'u dukën si ajo maqina e madhe që shtyp gurët, dhe që po më afrohej dalëngadalë për të më shtypur... Një çast më pas hodha sytë para dhe me vështrim ziliqari ndoqa atletin e «Partizanit». E kisha pothuajse njëqind metra përpara dhe ai ishte te fillimi i kthesës të dytë; domethënë i mbeteshin dhe dyqind metra për të këputur me gjoks shiritin e fitores. I shoqëruar nga duartrokitjet entuziaste të sportdashësve të vet, që qenë ngritur në këmbë, ai nisi sprintin e fundit. Ndërkaq unë përmblodha veten, shtrëngova fort dhëmbët dhe përsëri vura re se këmbët, sidomos të majtën, e urdhëroja me vështirësi. Përse më ndodhte

kështu? Mos vallë këmbët m'u rënduan nga lodhja, e cila, si njëlloj narkotiku, të përpin gjymtyrët... Mua frymëmarrja dhe krahët nuk më shqetësonin aq shumë sa këmbët. Vrapoja dhe mbaja vesh të dëgjoja hapa pas meje. O, sa më trembnin ato hapa, për të cilat do të jepja gjithshka që të mos i dëgjoja! Vrapoja dhe i murmurisja vetes:

«Edhe pak, edhe pak...»

Gjatë kthesës më dukej se trupi më anohej më shumë nga ç'duhej nga e majta, dhe më bëhej se nga çasti në çast do të rrëzohesha...

Tani që kanë kaluar kaq vjet profesor, them me vete:

«Çfarë e mbante trupin tim që të mos rrëzohej?»

Në qindmetërshin e fundit ndjeva të shpërthenin përsëri duartrokitjet. Unë e kisha përqëndruar gjithë vëmendjen te këmbët.

«Tani dhe duartrokitjet më trembnin. Ndoshta duartrokasin për Fotaqin, për Ruzhdiun dhe për atletët e tjerë që po më arrijnë!» — mendova gjithë ankth. Dhe vetëm kur kalova grumbullin e gjyqtarëve kuptova se ato më dhuroheshin mua...

Kur m'u afruat ju, vura re se fytyrës e sidomos syve tuaj u mungonte gëzimi.

«Duhej të tregoheshit më i sjellshëm dhe t'i respektoni më tepër ata që duan t'ju ndihmojnë» — më thatë duke më rënë shpatullave.

I prekur thellë në sedër nga fjalët tuaja, unë hyra kokulur në dhomën e veshjes. Gjatë ecjes ndjeva se këmba e majtë nisi të më dhimbte dhe këpucën mezi e mbatha. Po kësaj s'i vura rëndësi. Në kokë më ngacmonin fjalët që më kishit thënë pak çaste më parë. Më vinte shumë rëndë që ju kisha dëshpëruar. Dhe më pas, kur me ndihmën e një shoku shkova në

shtëpi, shprehja «Në garë njeriu tregon veten» më mundonte ndërgjegjen...

Në mbrëmjen e organizuar me rastin e mbylljes së kampionatit dhe të fitores së kupës nga ekipi i «Partizanit» unë nuk erdha. Nuk erdha, profesor, se nuk e ndjeja veten mirë. Gjatë kohës që ju kënaqeshit duke kërcyer e biseduar, unë ndjeja dhëmbje. E di se ju disa herë keni vështruar hyrjen duke pritur që, si një fëmijë i penduar, unë të vija e të ulesha pranë jush. Por, s'mund të vija dot deri atje. Këmba e majtë më ishte enjtur dhe tek nyja ndjeja dhëmbje. Me sa duket, gjatë garës, kur luaja me hapin tim, duke e shtrirë dhe mbledhur sipas ritmit të çrregullt të hapit të kundërshtarit, këmba e majtë më kishte shkelur mbi bordurën e bardhë dhe të hollë që ndan pistën nga fusha. Dhe kjo kish bërë të sajën. Ju atëhere s'e morët vesh këtë dhe, kur më pyetët pas ca ditësh se përse kisha munguar në shkollë, ju thashë se kisha nxjerrë kaviljen¹⁾ duke luajtur futboll me shokët. Kjo prirje për të mos thënë të vërtetën më pat mbyllur në vetëvete dhe më bëhej të besoja se, edhe po t'ju tregoja të vërtetën, do të më thoshit:

«S'do mend! Kur njeriu bën sipas kokës së tij...»

Më pas unë u mora me sportin që e kisha nisur që në vogëli. Dhe gjatë gjithë jetës sime sportive shprehja «Kur njeriu bën sipas kokës së tij» më ka vlejtur shumë.

1) Kavilje — nyja e poshtme e këmbës.

NJË NDESHJE DHE NJË DËSHIRE

Shokut B.J.

Gencit s'i kishte shkuar ndërmend se do të vinte një ditë dhe ai do të bëhej golashënuesi më i mirë i vendit. Por rasti nganjëherë të buzëqesh dhe atëhere kur s'e pret. Në ndeshjet e kampionatit të futbollit ai doli i pari në listën e lojtarëve që kishin shënuar më tepër gola në portën kundërshtare. Dhe kjo, pas dëshpërimit të humbjes dhe gëzimit të fitores që korrite skuadra e tij, i ndillte një kënaqësi të veçantë. Dhe ashtu si pikat e vogla të ujit që bien vazhdimisht në një enë dhe e mbushin, ashtu dhe për Gencin, çdo gol i shënuar në portën kundërshtare, ishte një pikë kënaqësie, që më në fund e mbushi plot vetëkënaqësi. Ai donte të pinte gotën e kënaqësisë që të jep çasti kur bëhesh golashënuesi më i mirë i vendit për të gjitha kampionatet e zhvilluara. Dhe ja, tani ai ishte në prakun e arritjes së ëndërrës së tij. I duheshin edhe dy gola, vetëm dy, që të arrinte dhe ta kalonte numrin rekord të golave të shënuar vite më parë.

Tek po bëheshin gati për të dalë në fushë, Genci hidhte tinëz shikimin e shqetësuar te shokët e skua-

drës, si të donte të diktonte te ata dëshirën e tij. Por ata merreshin me bluzat, me çorapet dhe me lidhësat e këpucëve. Traineri ecte poshtë e lart korridorit e, duke pirë me ngut cigaren, futesh në dhomën e zhveshjes dhe hidhte vështrime rretheqark si të donte t'i mobilizonte të gjithë lojtarët. . .

«I ka zënë të gjithë ethja e ndeshjes», — mendoi Genci, duke i ardhur keq që asnjërit prej shokëve të skuadrës, qoftë dhe trainerit, s'i shkante ndër mend për dëshirën e tij. Por ja, traineri ju afrua, ju ul pranë, i hodhi krahun dhe e pyeti:

— Si ndjehesh sot?

Genci uli sytë dhe, për të mundur shqetësimin që e kishte kapur, mori në çantë një portokall e filloi ta qërojë.

«Ç'të jetë pyetja e tij? — mendoi shpejt e shpejt. — E zakonshme si para ndeshjes, apo ka lidhje me dëshirën time!»

U mat t'i thoshte:

«Sot ndjehem si me fletë», por e përmbajti veten. Po në qoftë se ai e kishte pyetur si zakonisht para ndeshjes?

— Mirë, profesor, — tha Genci dhe, pasi e qëroi portokallin e ndau me ata që kishte pranë. Traineri futi në gojë thelën e vogël të portokallit dhe shtrëngoi fort midis gjuhës e qiellzës. Gencit ju duk se traineri diç bluante me vete.

— A jeni të gjithë gati? — pyeti pas pak traineri dhe hodhi një shikim të shpejtë përreth, siç bënte zakonisht kur vinte koha që t'i këshillonte për ndeshjen.

Lojtarët u afruan rreth tij.

—Po, — tha ai si me vete, — ndeshja e fundit dhe vendimtarja. Dhe traineri bëri një pushim të

shkurtër, si për t'u menduar më mirë për ato që do të thoshte.

«Sikur mos të qe ndeshja e fundit, — mendoj Genci me keqardhje. — Fundja të kishim dhe një tjetër, pastaj le të mbyllej kampionati».

— Fituam sot, dalim kampionë, — nisi të flasë mengadalë treneri, — ndaj mbani mend mirë detyrat taktike që duhen ndjekur gjatë ndeshjes. Skema e lojës «4-2-4», domethënë ajo që kemi praktikuar vazhdimisht. Mos u ndruani. Le ta dijë kundërshtari lojën tonë. Kjo s'ka shumë rëndësi. E rëndësishme është të luajmë «të gjithë për një, e një për të gjithë», dhe ai bëri prapë një pushim të shkurtër, po këtë herë me qëllim, që fjalët e fundit t'u futeshin mirë në kokë lojtarëve, të cilët po e dëgjonin në hesh-tje. — Në vend të Luanit, që pësoi traumë javën e kaluar, do të luajë Nasi.

Të gjithë kthyen sytë nga shoku i tyre më i ri, që do të luante në vend të Luanit. «Të kishte futur Kiçin, do të që më ndryshe», — mendoj Genci dhe u mat t'i thoshte trenerit e shokëve mendimin e tij. Po u tërhoq. Vështirë se treneri do të luante nga e tija, pastaj edhe shokëve s'do t'u pëlqente kjo. Të gjithë e dinin se me Kiçin ai ishte shok i ngushtë.

— Kini besim te Nasi, — shtoi treneri, si për të bindur Gencin. — Ai ka qenë shumë i rregullt në stërvitje, pastaj s'duhet harruar se mbrojtja kundërshtare do t'i ketë vënë qëllim vetes të mbulojë mirë Gencin dhe, sipas meje, mbrojtësit të Nasit, nga skuadra kundërshtare, do ti jepet detyra të dublojë Gencin. Për kundërshtarin Nasi është lojtar i ri, pa eksperiencë, por për ne është një Nas energjik dhe që s'ndruhet të gjuajë fort në portën kundërshtare.

«Keq, — mendoi Genci, — kjo do të thotë, o burrani, jepni pasa Nasit, se ky do të jetë si i lënë pasdore nga kundërshtari dhe, nga dëshira për të bërë gol, do të gjuajë përherë në portë. Bukur fort! I ri, po mua kush do të më pasojë? Ah, të ishte Luani. . . Po fundja edhe me Kiçin s'do të qe keq».

— Detyrën e kapitenit të skuadrës për sot ja ngarkoj Gencit, — vazhdoi treneri.

Të gjithë kthyen shikimet nga Nasi te Genci dhe e panë me dashamirësi. Luani, që ishte ulur në krah të masazherit, u ngrit me mundim nga vendi, i shtrëngoi dorën Gencit dhe i dha shiritin e kuq të kapitenit të skuadrës.

— Le të luajmë dhe sot «të gjithë për një e një për të gjithë» — tha treneri. — Loja jonë të jetë mbrojtja e fortë dhe e ngjeshur dhe sulmi i shpejtë dhe i fuqishëm. Ju uroj që kupa të na buzëqeshë në!

Genci u turbullua. Shuplaka që i dha treneri, duke futur në lojë Nasin, e shqetësoi, por detyra e kapitenit të skuadrës e mbushi me kurajo.

«Në djall të vejë dëshira, — mendoi, — dhe, në s'u bëfshin dy golat, s'është ndonjë gjë e madhe. Fundja, unë jam golashënuesi më i mirë i kampionatit», — dhe se si i erdhi kur kujtoi se ishte munduar të vinte në një peshore dëshirën e tij dhe marrjen e kupës.

— Ehe, — i tha Kiçi para se të dilnin. — Traineri shikon vetëm kupën.

Genci i mbërtheu sytë te fytyra e shqetësuar e shokut të tij. Për një çast atij ju fanit prapë dëshira për të bërë dy golat. . . Por tani ajo i dukej shumë e vogël ndaj dëshirës së madhe për të marrë kupën.

— Të kishe dalë në rregull në stërvitje, — i tha ai me zë bindës, — ndoshta do të gëzoheshim për të dyja.

— Por ti e di që unë isha me provime.

Genci vuri buzën në gaz si për t'i thënë:

«Mos harro se për skuadrën e trainerin kjo ndeshje është si provim i fundit dhe më i vështiri për të shpërblyer mundin e një viti të tërë», — dhe vrapoi për të dalë në nxemje.

Kiçi tundi kokën lehtë dhe u mat t'i thoshte:

«Po unë e kam për ty, se për mua nuk është «kushedi çfarë» pse s'po luaj. Fundja treneri e ka menduar mirë».

Genci qe larguar shpejt për të dalë në fushë dhe Kiçi nuk arriti t'ja thoshte këto. Tek qëndronte në stol pranë trenerit, ai vazhdimisht shpresonte të luante.

Traineri me të drejtë kishte caktuar Nasin në formacion dhe ai e mbështeti mirë arësyetimin e vet. Por prapë Genci ndjente nevojën që të kishte në krah një lojtar që t'i njihte lojën dhe t'i pasonte atëhere kur duhej.

«Pastaj, — mendoi prapë Kiçi, tek ndiqte me ankth zhvillimin e ndeshjes që sapo kishte filluar, — për gjysmë loje unë jam në gjendje të jap më shumë se Nasi».

Stadiumi gumëzhinte nga thirrjet e herëpashershme të spektatorëve. Ata ishin të shqetësuar për fatin e ndeshjes aq sa edhe vetë lojtarët. . .

Kishte kaluar gjysma e lojës së pjesës së parë dhe asnjëra nga skuadrat s'kishte shënuar. Loja zhvillohej e shpejtë. Topi shkonte për atje ku e nisnin lojtarët. Rrallë e tek të kapte syri ndonjë pas të gabuar. Gjuajtjet s'vononin t'i drejtoheshin kuadratit të bardhë të portës. Por portjerët ishin, si i thonë, «në formë».

Genci megjithëse përherë ndodhej midis dy mbrojtësve kundërshtarë, punonte mirë. Topin mun-

dohej mos ta mbante shumë. Nga kjo, të dy mbrojtësit që i qëndronin vazhdimisht pranë u bënë nervozë. Atyre u dukej se s'po e kryenin detyrën e tyre, pasi s'po mundnin ta pengonin Gencin në manovrimet dhe në pasimet e sakta që bënte. E vetmja gjë që i ngushëllonte ata, ishte se Genci akoma nuk po mundte të shënonte. Dhe vetë Genci kishte nisur të shqetësohej. Mendimi se minutat po shkonin dhe se skuadra e tij s'po kalonte në avantazh, e mundonin. Gjer kur kësh-tu? Ai e dinte mirë se tifozët e skuadrës së vet e kishin varur shpresën e fitores te ai, te aftësia dhe mjeshhtë-ria e tij për të nuhatur portën dhe për të shënuar golin.

«Megjithatë, — mendoi, — ata po e kuptojnë se një gol në këtë ndeshje vlen sa për dy gola të shënuar në ndeshjet e kaluara. Mbrojtja dhe portieri sot po luajnë mirë. Pastaj ata po e shikojnë se si më ruajnë. Vërtet Nasin e lënë nganjëherë si të «harruar». Po dhe ai po ja bën shërbimet topit. I është afruar dy-tri herë portës, ka gjuajtur fort dhe vetëm hedhjet e guximshme dhe pritjet e sakta të portierit s'e kanë lejuar topin të përplasej në rrjetë. Po sikur të ndër-rojmë vendet? Ndoshta mbrojtja kundërshtare e ka si variant të saj të ruajë më fort mesin se krahët. . .»

— Nasi, — thirri lehtë ai kur i qe afruar shokut. — Për pak do të sulmoj unë në krah. Ti mundohu të gjuash nga përballë kuadratit të portës.

Nasi vrapoi ashtu siç e porositi kapiteni i skuad-rës.

«Ndoshta për këtë më qorton treneri», — men-doi Genci dhe u përgatit të dëgjonte ndonjë thirrje nga shokët që rrinin në një stol me trenerin. Por jo. Dëgjoi vetëm thirrjet herë shqetësuese e herë inkura-juese të sportdashësve.

Genci e bëri këtë ndërrim vendesh për t'ju shmangur dy mbrojtësve kundërshtarë. Por ata prapë, edhe në rolin e anësorit, e kishin Gencin nën kontrollin e tyre.

«Fundja kështu do t'i jepet rasti më tepër Nasit për të gjuajtur më shumë», — mendoi dhe u tërhoq pak prapa, sa për t'u marrë vesh me shokët që ta furnizonin më shumë me pasa. Dhe ja ku topat nisën të vijnë më shpesh drejt tij. Ai, pasi i përpunonte pak, ja kthente Nasit. Loja u gjallërua dhe më shumë. Nasit dhe pastaj portierit të skuadrës kundërshtare ju hap më tepër punë. Tani tifozat u përqëndruan te Nasi. Dalëngadalë mbrojtja kundërshtare po kujtohej të mbronte mesin. Këtë e bënte jo si variat të saj, po ngaqë Nasi dhe shokët e tij të sulmit, të nxitur nga pasat e shpeshta e të sakta të Gencit, depërtonin dhe gjuanin më shpesh. Dhe goli s'vonoi. Genci ndërmori një aksion personal, ju shmang me zotësi mbrojtësve që i rrinin përherë pranë, depërtoi dhe, kur u gjend pranë portës, e pasoi topin me gjakftohësi te këmbët e Nasit, i cili me një ndërhyrje të shpejtë e dërgoi topin në rrjetë. Gol...! Thirrjet entuziaste të tifozave arritën kulmin. Të ngritur në këmbë me krahët lart, tundnin duart si të ishin buçeta me lule. Në fushë, i pari e shijoi gëzimin e golit vetë Nasi. Një çast pas gjuajtjes, ai shtangu me shikimin të ngulur te rrjeta, por kur ajo u tund, ai kërcëu përpjetë dhe, sapo këmbët i prekën tokën, u sul me vrap dhe ju hodh Gencit në qafë, si për t'i thënë: «Sa i mirë je ti, Genci!» Pastaj pranë tyre vrapuan dhe shokët e tjerë të skuadrës...

Dhe ja ku ndodhi ajo që në çdo sport, sidomos në futboll, i thonë «e papritura». Akoma pa u ulur mirë vala e spektatorëve tifozë, akoma pa e kthyer

lojtarët gjer në fund kupën e gëzimit për golin e Nasit, skuadra kundërshtare e nisi topin nga qendra dhe me një pas të gjatë, e nxori në pozicion sulmuesin e majtë, i cili, i nisur me sprint, i kaloi mbrojtësit, ju afrua me vrull topit, shutoi fort dhe gol! «E pauptura», me shpejtësi të rrufeshme, bëri të sajën. Të tjerë lojtarë vrapuan drejt shokut të tyre që posa shënoi, të tjerë tifozë, që çaste më parë rrinin të heshtur e të stepur, si me sustë u hodhën lart duke thirrur herë pas here «Gol». Lojtarë e tifozë që pak më parë provuan shenjën e gëzimit, tani, brenda një minute, me duart mbërthyer në bel, shikonin nga arbitri që kishte shtrirë krahun dhe tregonte me dorë mezin e fushës, nga do të niste prapë loja, e cila pas pak u ndërpre nga sinjali i bilbilit që lajmëroi mbarimin e pjesës së parë. Lojtarët vrapuan dhe u futën në dhomat e tyre. .

Genci i ulur në stol, afroi çantën pranë vetes dhe mori portokallin që i kishte mbetur, por s'i bënin gishtat ta qëronte. Një orë më parë ëndërra për t'u bërë golashënuesi më i mirë i kishte turbulluar mendjen, pastaj dalëngadalë e kishte rrëmbyer dëshira për marrjen e kupës, dhe tani, që sapo kishte mbaruar pjesa e parë e lojës, kishte nisur të shqetësohej vërtet për fatin e ndeshjes. I bëhej të besonte se fitorja do t'i buzëqeshte skuadrës kundërshtare. «Dreqi ta marrë, — hëngri inat me veten, — nganjëherë s'është me të bërë, po me të thënë. Sporti është punë shansi!» Ai u hodhi një vështrim shokëve dhe u bind se edhe ata po mendonin si ai. Vetëm te fytyra e trenerit nuk vuri re shqetësimin e mëparshëm dhe as merakun për fitore. «Ç'i thotë mendja?!» — mendoi dhe u kthye të shikonte shokun që kishte pranë dhe që i mori portokallin nga dora.

— Po ju ecën loja mbarë, — i tha lehtë Kiçi, duke qëruar portokallin. — I mpreha takat të luaja lojën e dytë, po Nasit sot nuk i dilet përpara.

Genci u mundua të qeshte me singëritetin e shokut të vet dhe i hodhi krahun si për t'i thënë: «S'do të thotë gjë se kush luan. E rëndësishmja është të fitojmë».

— E di, Genci, — tha lehtë Kiçi, — mbrëmë natën pashë veten në ëndërr. Të qëndroja në krah si tani, jo këtu, po atje në pistë, duke bërë rrethin e fitores. Ti me krahët lart mbaje në duar dy kupat: atë të kampionatit dhe të golashënuesit më të mirë të vendit. Por siç duket në rrethin e fitores s'do të jemi pranë. Eh, si janë ëndërrat!

Genci buzëqeshi me gjithë zemër dhe e afroi Kiçin pranë vetes si për t'i thënë: «Ç'qerrata djalë që je!»

Ndërkaq Kiçi i dha portokallin e qëruar.

— Po më jep kupën, — qeshi Genci.

— Ti e ke me tallje, — ja ksheu Kiçi.

— E po, na atëhere, — dhe Genci e ndau portokallin përgjysmë. — Ti merr atë të kampionatit dhe unë atë të golashënuesit më mirë.

— Jo, — tha Kiçi, — ashtu si në ëndërr, mbaji ti të dyja.

Genci qeshi prapë dhe desh t'i thoshte diçka, po vuri re se treneri dhe shokët po e vështronin.

— Po Kiçi, s'ka marrë portokalle për ndeshje? — pyeti buzëgaz Gencin treneri.

— I kishte marrë, po ja hëngri Nasi rrugës, — tha Genci dhe të gjithë ja shkrehën gazit.

— Ej, ja ku i kam, — thirri Kiçi, — dhe nxori dy portokallet nga çanta.

Të gjithë kthyen vështrimet e përzemërta nga

shoku i tyre i skuadrës, që s'kishte dalë në rregull në stërvitje për shkak të provimeve.

«Ej, ç'po vete», — tha me vete Genci. — Na e largoi mendjen nga ndeshja.

— Mirë atëhere,— tha treneri, — meqë qenka përgatitur për ndeshje me të gjitha, jepi një kokërr Nasit dhe tjetrën haje vetë, po pasi t'i kesh shtrënguar mirë lidhësat e të jesh bërë gati për ndeshje.

Tani të gjithë e përqëndruan vështrimin te treneri. Masazheri ju afrua Kiçi si për t'i thënë «Hajde, bëhu gati shpejt». Po Kiçi vazhdonte të shihte trenerin me habi.

«Thashë unë, — mendoj Genci, — që ky diç po bluante!»

— Po luajmë siç na ka hije, — vazhdoi të flasë treneri. Tek qëndronte në këmbë, ai kishte mbështetur shpatullat në derë. Traineri kishte një zakon: gjatë këshillave që i jepte skuadrës nuk lejonte të hynin në dhomë persona të tjerë. Të gjithë po e dëgjonin me vëmendje. — Rëndësi ka që ne e kaluam hutimin që na solli pësimi i shpejtë i golit. Futbolli i ka këto. Gjatë lojës Genci punoi me fantazi. Tani kujdes! Të lumtë, Nasi! — dhe treneri i dha dorën. — Ti luajte sa munde. Por kundërshtari e vuri re taktikën tonë. Me siguri ai do të marrë masa që Nasin ta ketë më në kontroll. Po ne do t'i bëjmë një «blof». Nasi do të pushojë. Kiçi dhe Genci do të mbajnë barrën e sulmit në krahun e tyre. Të kenë kujdes që t'i japin shkëndijë sulmit me aksione dyshe. Kiçi do të mundohet ta nxjerrë shokun në rast të volitshëm shënimi. Mos harroni se edhe kundërshtari po luan mirë. Te jemi të matur në çdo çast që do të kemi të bëjmë me topin..

«Kështu po, — mendoj shpejt Genci. — Tani Kiçi

do të punojë për mua, ashtu siç e kisha bërë hesap edhe unë. Shiko si m'u bë për mbarë!»

— S'të kam parë kot në ëndërr, — i tha me shpoti Kiçi, dhe deshi të shtonte: «Mua më dalin ëndërrat». — Pastaj, si s'të shkrepri ta gjuaje vetë po ja dhe golin Nasit, tamam si qofte.

— Ai e kishte më të sigurtë, — tha me gjysmë zëri Genci.

— Të gjithë ne prisnim që të gjuaje ti, bile dhe treneri. Ai u ngrit në këmbë kur ti u ndodhe pranë portës, pastaj u shtang dhe në fund u gëzua për golin e Nasit. Po vura re se do të gëzohej më shumë sikur të kishe shënuar ti.

— Vërtet? — tha Genci.

— Hajde se shokët po dalin, — tha Kiçi dhe të dy u përgatitën për të dalë në fushë.

Genci doli i fundit nga dhoma. Ëndërra që kishte nisur të përpëlitej brenda qënjes së tij, tani i mori përsëri flatra. Tifozët e pritën me duartrokitje dhe thirrje të gëzuara daljen e tij. Një tifoz bërtiti nga tribuna:

— Hajde Genci. S'duam më tepër! Dy. Vetëm dy dhe mori fund...

Disa nga spektatorët, të cilët ishin pranë tifozit që foli, nisën të qeshnin, ndërsa të tjerët e pasuan dëshirën e tij me thirrje aprovuese.

— E, — murmuriti Genci, — dy, vetëm dy dhe kupa e vogël e golashënuesit do të jetë në duart e mia. Pastaj ato janë të lidhura ngushtë si dy motra me kupën e kampionatit. Po bëra dy gola, me siguri ndeshjen do ta fitojmë ne. Sa mirë sikur të më vejë mbarë!

Në fillim të pjesës së dytë tifozët u stepën; nuk ju erdhi mirë që Nasi u ul në stol. Po pastaj u gjallë-

ruan prapë. Skuadra e tyre e zemrës po luante me ritmin e lartë të pjesës së parë. Kishin kaluar dhjetë minuta dhe mbrojtja kundërshtare akoma s'e kishte të qartë detyrën e saj. Futja e Kiçit u nxori vërtet telashe. Megjithëse Gencit i gjendeshin përherë pranë dy mbrojtës kundërshtarë, prapë, si qendërsulmues aktiv, ai manovronte dhe i shpërndante topat në të dy krahët. Vetë nuk kishte marrë ndonjë aksion personal. Këtë e bënte me qëllim. Duhet t'i gjente mbrojtësit të papregatitur për të penguar ndërhyrjen e tij drejt portës. Një herë Kiçi u bë nervoz dhe, kur ish-in pranë njëri-tjetrit, i tha tërë inat:


— Ç'pret akoma. Mos do që mbrojtësit të bëjnë autogol për ty.

— Ashtu, ashtu, po ti vazhdo të krososh e të pasosh siç ke bërë gjer tani.

— Posi, — shfryu prapë Kiçi, — që t'i dërgosh topat në krahun tjetër.

— Hajde, më i qetë. Çdo gjë kërkon çastin e vet.

Nervozizmi i Kiçit i dha të kuptonte Gencit se e kishte tepëruar në shpërndarjen e topave në krahun tjetër. «Po ja arrij qëllimit, — mendoi, — nervozohen shokët, por njëkohësisht përgjumet dhe mbrojtja. Kjo nuk është si ndeshjet e tjera. I thonë finale. Mirë e tha treneri: «Të jemi të matur». Por, stadiumi gjëmoi nga brohoritjet. Skuadra kundërshtare kishte shënuar dhe kishte kaluar në avantazh. Haresë së golit pas pak ja zuri vendin shqetësimi i tifozëve të tjerë, për fatin e hidhur të ndeshjes; fishkëllimat e herëpashershme tregonin se ata donin gjuajtje në portë, donin gol. Dhe Genci, më shumë se shokët e skuadrës, e ndjente shqetësimin e tifozëve. Fishkëllimat e vrisnin në sedër. «Prisni edhe pak, — tha



me vete dhe i erdhi inat që dy shokët e krahut të djahtë, megjithë pasat e shumta të tij, s'po mundnin të shënonin. Topat e shpeshtë që i vinin nga mbrojtësit e gjysmëmbrojtësit e tij, tregonin se shokët e kishin varur shpresën te ai. «Edhe pak, — mendoj prapë Genci dhe i hodhi një shikim Kiçit, që kishte filluar të sulmonte vetëm. «Eh, kujton se jam topitur!» — mendoj dhe, duke pasur kujdes mos ta kuptonin mbrojtësit, ngriti krahun lart nga ana e Kiçit, si për t'i thënë: «Kiçi, tani kujdes!»

Kishin kaluar disa minuta nga pësimi i golit dhe fishkëllimat e tifozëve. Genci kishte vënë re se mbrojtësit herë-herë tërhiqeshin të ndihmonin shokun e krahut të tyre nga ana ku mudohej të depërtonte Kiçi. Ndaj pasat e fundit që mori, ai ja lëshoi para Kiçit, që i turrej topit me tërë energjitë, duke tërhequr si një magnet i fortë në krahun e tij dy gjer në tre mbrojtës.

— Tani, tani, — i dha kurajo vetes Genci, dhe prapë i ngriti krahun Kiçit, si për ti thënë: «Tani duhet të më pasosh». Sulmet energjike të Kiçit i kishin dhënë shkëndijë vijës së sulmit. Tifozët, sikur ta ndjenin «erën e golit», qenë ngritur në këmbë dhe shpresat i kishin vënë te krahu i Kiçit. Genci mori topin, ja lëshoi Kiçit përpara, po këtë radhë u sul edhe vetë përpara portës, duke ju shkëputur mbrojtësve që s'e prisnin shpërthimin e tij. Në vrap e sipër shkemoi në ajër topin që ja kishte kthyer Kiçi dhe gol! Një gol i bukur, që i bëri tifozët të hidheshin përpjetë nga entuziazmi. Shokët e skuadrës vrapuan e ju hodhën përqafe. Rezultati u barazua.

— Dhelpër, — i tha Kiçi kur po vraponin për të zënë vendet në mesin e fushës, — na tërbove fare.

Genci vuri buzën në gaz, tek pa që shoku i tij po lehtësohej pak nga pak nga lodhja dhe emocionet.

Ndërkaq në shkallët e stadiumit jehonin thirrjet: «Edhe një. Edhe një...»

— E kanë me ty, — i tha Kiçi.

Genci e ktheu kokën instinktivisht dhe gjithë ankth hodhi vëshrimin nga ora e madhe. Ai e kuptoi se thirrjet i drejtoheshin atij se, edhe tifozët, në këto pak minuta që kishin mbetur, dëshironin që ëndërra e tij të bëhej realitet. «Jo vetëm duan, — mendoj Genci, — por edhe shpresojnë», — dhe, i gëzuar që dashamirësit e skuadrës jetonin dhe dëshirën e tij, u hodh në sulm me të gjitha energjitë.

Por s'ishte vetëm Genci që bënte një gjë të tillë. Tani lojtarët e të dyja skuadrave po luanin megjithë shpirt për të shënuar golin e fitores. Genci vuri re se e gjithë mbrojtja kundërshtare ishte nervozuar. Me sa duket, goli i tij kishte qenë i papritur për ta. «Tani në çdo rast duhet depërtuar për në portë», — mendoi shpejt dhe bëri nga krahu i Kiçit. — Cilido qoftë nga vija jonë e sulmit duhet të depërtojë, — i tha Kiçit kur i shkoi pranë.

Tifozët e të dyja skuadrave ishin ngritur në këmbë. Ankthi se po mbaronte loja, dhe dëshira e madhe për t'u bërë goli, i bënte të mos qëndronin ulur. Vetëm trainerët, sikur ta dinin se diçka do të ndodhte, qëndronin në stola, duke i thithur fort cigaret që s'i kishin shuar asnjëherë gjatë gjithë ndeshjes. Pas pak stadiumi ra në qetësi, ndërsa Gencit akoma i kumbonin në vesh thirrjet: «Edhe një, edhe një!» Dhe ajo, që trainerët i shqetësonte përbrenda, por që ishin mësuar ta mbanin të ndrydhur gjer në çastin e fundit të lojës, ndodhi. Genci ndërhyri për top të parë të një mbrojtës kundërshtar, ja mori, eci para dhe

në çastin kur e pasoi te shoku i krahut të djathtë, mbrojtësi e preu të këmbët nga prapa dhe e rrëzoi. Fishkëllime të forta, por gjyqtari kishte lejuar avantazhin. Topin e mori sulmuesi i djathtë, i cili nuk nguroi, po u fut në zonë dhe në çastin kur do të gjuante e shtynë dhe e rrëzuan për tokë. U dëgjua fishkëllima e bilbilit të arbitrit dhe penallti. Brohoritje të forta në shkallët e stadiumit për shumë çaste dhe pastaj përsëri ankth. Genci i rrëzuar jashtë vijës së gjastëmbëdhjetëshit bëri të ngrihet, por u rrëzua prapë. Shokët ju mblodhën rreth.

Për në fushë u nisën me vrap treneri dhe masazheri, por arbitri i ndaloi. Genci, i ndihmuar nga shokët, u ngrit. Ndjeu dhembje në këmbë, por duroi. Nuk i rrihej pa parë gjuajtjen e penalltisë. Prapë thirrje entuziazte nga shkallët. Dhe Genci ndjeu atë që ndjen kushdo kur sheh se dëshira e tij është edhe dëshira e të gjithëve, se ëndërra e tij është edhe ëndërra e të gjithëve. . .

Tifozët me gjithë zemër thërrisnin emrin e tij:
«Genci! Genci!»

U vu topi në pikën e bardhë të njëmbëdhjetëshit dhe portieri nisi të shkundte krahët e bashkë me to dhe emocionet që e kishin pushtuar. Po topit s'po i afrohej asnjë nga lojtarët. Ata qëndronin si të ngrirë, sikur të mos e kishin mendjen te penalltia. Thirrjet s'pushonin. Ç'donin ata që ngurronin aq shumë?!

Arbitri ju afrua topit dhe, si të donte të shpëtonte portierin dhe lojtarët nga ankthi, ftoi kapitenin e skuadrës dhe e urdhëroi që të gjuante penalltinë. Një çast kapiteni i skuadrës dhe të nëndë lojtarët i drejtuan sytë nga shoku i tyre, që i gjuante për herë penalltitë. Atëhere Bujari lëvizi para, qëndroi një hop dhe, si të donte të dëgjonte më mirë thirrjet e njëkoh-

shme e të kristalizonte më mirë vendimin që kishte marrë, u kthye nga Genci, i zgjati krahun dhe e afroi pranë topit. Atëhere thirrjet kumbuan më fort. Shokëve të skuadrës, u ndritën sytë nga një ndjenjë, që dhe ata vetë në ato çaste s'ishin në gjendje ta kuptonin.

«Të gjithë duan — mendoj Genci — të gjithë». Dhe u kthye nga treneri, që, bashkë me masazhierin, kishte mbetur në këmbë te vija anësore. Traniери e ndjeu vështrimin pyetës së Gencit. Ai uli kokën mengadalë dhe e ngriti përnjëherësh, si të donte të thoshte:

«Jepi, Genci, se ty të përket! Ç'është për t'u bërë le të bëhet».

Pas kësaj Genci u kthye nga topi, përplasi disa here majën e këmbës së djathtë në tokë, eci mengadalë dhe mori topin në duar. «Ky çast, — mendoj, — Vlen sa për të dy kupat». Dhe vuri pranë topin në pikën e bardhë të njëmbëdhejtëshit. Pastaj u kthye, mori vrull, e shtriu mirë këmbën dhe e shkëlmoi topin me aq forcë, sa ju bë se kështu s'e kishte shkëlmuar ndonjëherë tjetër, topi si një zog i shpejtë, u nis dhe pa e penguar ndokush u përplas në rrjetë.

Thirrje të stuhishme gëzimi ushtuan në gjithë stadiumin dhe u përhapën tej. Genci ngriti krahët lart, si të donte të fluturonte nga lumtëria që ndjente. U kthye. Shokët e prisnin krahëhapur. Rendi dhe u hodh në krahët e tyre.

AFËRDITA

Binte një shi i butë dhe i imët. Udhëtarët shpejtonin dhe, pasi kalonin derën e vogël të hyrjes ku priste biletat fatorinoja, drejtoheshin për në vagona. Sheshi i vogël i stacionit dukej si i braktisur nga njerëzit.

Një grup vajzash, me çanta sportive ndër duar, qëndronin më këmbë afër trenerit të tyre, para bufës së stacionit. Ato hidhnin hera-herës vështrimin nga rruga dhe shikonin pastaj orën e madhe të stacionit. Traineri, i shqetësuar, lëvizte para tyre me çadër në dorë, shikonte orën e stacionit, e me marifet nxirrte orën e vet dhe e kontrollonte. Fishkëlleu sirena e trenit, e cila i paralajmëronte udhëtarët që të hipnin në vagona. U dëgjua thirrja e fatorinos që u drejtohej vajzave të afroheshin, dhe pastaj zëri i fortë i trenerit:

— Kush e ka takuar për herë të fundit Afërditën?
Vajzat shikuan njëra-tjetrën.

— Domethënë, dje s'e ka parë ndonjëra.

— E kam parë unë, profesor, — tha si me ndrojtje një nga vajzat e skuadrës së basketbollit.

— Mos ishte gjë e sëmurë? — pyeti treneri.

— Jo, profesor! Mbrëmë, kur dola nga kinemaja dhe po shkoja për në shtëpi, e pashë Afërditën. Ajo po dilte nga lulishtja me të fejuarin.

— E takove?

— Jo. Më duket se bëri sikur s'më pa. Ndoshta s'më pa me të vërtetë, megjithëse më kaloi fare pranë.

Traineri mbylli çadrën, sikur të mos binte fare shi dhe, duke tundur lehtë kokën, foli si me vete:

— S'e ka bërë herë tjetër këtë, — dhe, pasi u bëri vajzave shenjë me kokë, u drejtua nga dera e hyrjes.

Kur ra sirena e dytë dhe faktorinoja u bë gati të mbyllte derën, te sheshi ndaloi një taksi që vinte me shpejtësi të madhe.

Një vajzë me shtat të lartë zbriti dhe vrapoi te hyrja.

Treni rrëshqiste mbi shina me zhurmën e tij ritmike dhe monotone. Vajzat e ndjenin veten të gëzuara nga ardhja e shoqes së tyre, që gjithnjë kishte qenë e rregullt.

Të gjitha ato kishin një dashuri shumë të madhe për sportin, por ndër to më tepër dallohej Afërdita. Nuk i ishte ndarë skuadrës që katërmbëdhjetë vjeçe. Tani ajo i kishte arritur të nëntëmbëdhjetat dhe ishte një nga vajzat që jepte më tepër për fitoren e skuadrës së vet. Ndaj edhe traineri e kishte caktuar kapite-ne të skuadrës.

Ishte dita e parë e fillimit të kampionatit dhe ndeshjen e parë, sipas shortit, po shkonin ta zhvillonin në qytetin K. Skuadra vendase ishte një rivale e fortë. Trainerit nuk i kishte ardhur mirë që ndeshjen e parë po e zhvillonin jashtë qytetit, ndaj i kishte porositur vajzat ta merrnin me shumë seriozitet këtë takim. Kjo do të ndikonte pastaj në moralin e skuadrës për ndeshjet e ardhshme.

— Profesor, — ju drejtua trainerit një nga vajzat,

— s'do të na tregosh sot ndonjë nga ato ndodhitë sportive që kanë të bëjnë me forcën e pasionit?

Traineri u kollit lehtë, si për të treguar se sot diçka kishte që e pengonte dhe, pasi pa orën, u foli atyre me zë të ulët:

— Është koha për të ngrënë mëngjezin.

Vajzat që u kujtuan tani për mëngjezin, morën çantat ndër duar. Ndërkaq treneri e ndali vështrimin te Afërdita që qëndronte përballë tij. Ai vuri re leshrat e saj të krehura pa kujdes, sytë pak të skuqur dhe kopsën e sipërme të bluzës të pambërthyer mirë. Mendoj: «Ç'ti ketë ndodhur vallë? Kjo akoma s'po kujtohet që nga nxitimi ka harruar çantën në shtëpi. . . Afërditës gjithmonë i kanë pëlqyer udhëtimet, ndërsa sot është kaq e shqetësuar!»

Afërdita, me kokën të kthyer pak djathtas, vështronte e vështronte përtej xhamit të dritares, sikur të donte të përpinte me sytë e saj të kapitur nga pagjumësia arat që gjelbëronin nga gruri i ri, vreshtat e punuara me shumë kujdes dhe lulet e bardha e ngjyrë rozë të qershive e të pjeshkëve. . . Një tufë rrezesh të ngrohta ranë mbi fytyrën e saj dhe ajo uli shpejt qepallat e vuri dorën mbi sy. Shiu tani kishte pushuar dhe dielli po dilte nga retë e përhimta që mundoheshin ta fshihnin.

— Afërdita, — i foli me zë atëror treneri si për ta zgjuar nga topitja që e kishte pushtuar, — merr këtu diçka për të ngrënë, — dhe vuri në tryezën e vogël letrën me të cilën kishte mbështjellë mëngjezin.

Vajza e largoi dorën nga sytë dhe e shpuri pranë këmbëve, si të donte të merrte diçka. Atë çast ajo u kujtua për çantën që e kishte harruar në shtëpi dhe i erdhi shumë rëndë.

— Oh, profesor...

— Merr këtu, Afërdita, — e ftoi përsëri ai me përzemërsi, — pastaj shohim e bëjmë.

Ajo zgjati dorën si me turp.

Ca tinguj të ëmbël kitare kumbuan në vagon dhe vajzat nisën të hanin mëngjezin me ëndje. Alto-parlanti i vogël i vagonit po jepte një pjesë me kitarë. Vajzat dëgjonin me kënaqësi, vetëm Afërdita dukej si e humbur. Ajo kishte rënë përsëri në mendime...

«Ti s'do të luash më! — i kishte thënë mbrëmë i fejuari, tek qendronin të ulur në një nga stolat e lulishtes».

«Si kështu?! — ishte përgjegjur ajo».

«Tani ti do të bësh si të them unë. Sot je fejuar. Nesër do të martohesh. Në jetë çdo gjë shkon sipas moshës».

«Përse s'ma ke thënë më përpara këtë?».

«Po ja, ashtu. Mund edhe të më zëmëroheshe».

«Po tani?».

«Pa mendo një herë ç'do të thotë të jesh grua. Do të mbash mbi supe gjithë barrën e shtëpisë».

«Po ti s'do të më ndihmosh?».

«Si të të ndihmoj? Ti të shkosh të luash me top e unë të mbytem në punët e shtëpisë? Ti të bredhësh të shtunave e të dielave nëpër qytete ku bëhen ndeshjet, dhe unë të bëhem dado e fëmijëve! Jo, kjo nuk mund të ndodhë».

«Si është e mundur t'i thuash gjithë këto fjalë?»

«Një herë do të thuheshin!».

Tingujt e kitarës kishin pushuar dhe vajzat tani qëndronin të heshtura. Traineri vështronte herë ato e herë shoqen e tyre, që vazhdonte të qëndronte me sytë të mbërthyer te xhami. . .



«Këto mund t'i thotë vetëm një njeri i cekët, — mendoi ajo. — Po edhe ai vetë merr pjesë në aktivitetet shoqërore të ndërmarrjes. Pastaj harroi ai që ne u njohëm pas ndeshjes së fundit të kampionatit të vitit të kaluar? Atë mbrëmje sapo isha ndarë nga shoqet, kur ndjeva hapat e tij. Isha e gëzuar si të gjitha shoqet e skuadrës, se kishim fituar edhe ndeshjen e fundit të kampionatit. S'më erdhi aspak çudi kur ai më thirri në emër, sikur të më njihte prej kohësh. Qëndrova. Nuk e di pse s'kisha forcë ta kundërshtoja, kur ndenja dhe pak më gjatë me të! Ndoshta nga që doja ta dëgjoja kur të më fliste. S'e kisha menduar kurrë se dashuria ime do të niste kështu, kaq shpejt, kaq thjesht... Duke ecur rrugës me të, e ndjenja se dalëngadalë gëzimi i ndeshjes po më shndërruhej në lumturi... Ecnim pranë e pranë njëri-tjetrit. Herë-herë doja të flisja dhe unë. Po ai më ndërpriste: «Sonte vetëm më dëgjo, — më thoshte duke buzëqeshur, — se je e lodhur, ke luajtur me gjithë shpirt...» Që prej asaj dite filluan të takoheshim më shpesh. Ne duheshim. Këtë e vunë re dhe të tjerët që na njihnin. Nganjëherë atij s'i pëlqente që shkoja në stërvitje të shtunave, po megjithatë vinte dhe më priste kur dilja nga parku sportiv... U fejuam dhe kjo na dukej një diçka që do të përlligjte dashurinë tonë. Dhe kurrë s'më kishte shkuar ndër mend se do të vinte një ditë që, njeriu i zemrës do t'i vinte kusht së ardhmes sonë!»

... Vajzat rrinin të menduara dhe e hidhnin vështrimin herë nga shoqja e tyre, herë nga dritarja. Ato rrinin të heshtura, siç rri çdo njeri kur ka ndonjë shqetësim. Tani për to ishte e qartë se shoqen e tyre e mundonte diçka. Afërdita ngriti kokën që e kishte lëshuar midis pëllëmbëve dhe, duke u kujtuar që

s'ishte vetëm, vështroi si me turp trainerin e shoqet.

«Ti s'do të luash më, — i kishte thënë ai rreptë edhe para prindërve të saj, kur ajo po bëhej gati të nisej për në stacion. — More vesh, ti s'do të luash më!»

Ajo kishte heshtur si për të matur se sa thellë shkonte ai në dobësinë e tij.

«Fjalët që t'i thashë mbrëmë, vëri vath në vesh, se s'ti thashë për të kaluar kohën».

Ajo kishte shtangur. Nga mënyra se si shprehej, e kuptoi se ai do ta thellonte më tepër kërkesën e tij po t'i nënshtrohej dëshirës së të fejuarit. Ndaj e vështronte atë ftohtë, pa ja ndarë sytë për asnjë çast. Ç'kishte ndodhur me të? Mos vallë ndonjë shok i kishte folur keq? Jo, për të s'kishin pse të thoshin gjë. Ai tani duhej ta njihte më mirë se kushdo tjetër. Po atëhere. Ndoshta në fillim ai s'i kishte folur keq për sportin, se ashtu i interesonte; pastaj, sa ja kishte arritur së tijës, kishte vendosur të sillej ndryshe. Jo, jo, s'mund të ishte i tillë. «Si nuk mendon për dëshirën time të fortë, për vullnetin në stërvitje; sa e sa femra si unë kalisin karakterin e tyre ndoshta më mirë se të tjerat, të cilat, në kohën lirë, kur ne merremi me stërvitje, shëtisin rrugëve, ose merren me vogëlsira. Përse të ndodhë kështu me dashurinë time?»

Ndërkaq zëri i babait e kishte mbushur me ngrohtësi.

«Dëgjo këtu, djalë i mirë. Në qoftë se sporti do të ndikonte për keq te vajza jonë, unë i pari, si prind, s'do t'ja lejoja kurrë këtë. Por ti s'e ke kuptuar drejt këtë punë».

Ajo, e çelur në fytyrë dhe krenare që kishte prindër të tillë, i kishte zgjatur dorën të fejuarit si të donte t'i thoshte: «Hajde, lëri mënjanë mendimet e ngrysurat dhe eja më përcill!»

Por ai kishte qëndruar edhe pak me sytë e mbërthyer te fytyra e saj dhe pastaj, sikur t'i thoshte mendja diçka, së cilës edhe ai vetë s'mund t'i jepte zgjidhje në ato çaste të vështira, tundi kokën... Kushedi se çfarë i silleshin nëpër mendje në ato çaste; thashethemet për femrën që merret me sport, ndonjë njeri i afërt që i kishte futur në kokë mendime të ulëta për sportin, a ndoshta diçka tjetër. Pastaj ai kokulur kishte dalë përjashta pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja. Asaj i kishte ardhur keq që ai e kishte çuar veten në atë gjendje. Kushedi, kishte menduar ajo dhe kishte vrapuar drejt stacionit...»

— Afërdita! — i foli ngadalë treneri duke e prekur lehtë në sup, — mbërritëm.

Ajo kaloi e shkujdesur dorën nëpër flokët e shpupurishur, si për të larguar nga koka andrrallat që e kishin munduar, dhe shikoi e ndrojtur trenerin e pastaj shoqet, si për t'u kërkuar atyre ndjesë, që gjatë udhëtimit kishte qëndruar larg tyre, larg shqetësimit për ndeshjen që po shkonin të zhvillonin.

— O, po edhe ju paskeni heshtur të gjithë si unë!

— Na rrinte mendja te ndeshja, — u justifikua treneri.

— O, vërtet! A do të fitojmë, profesor?

— Po varet se si do të luajë skuadra, Afërditë. Sa do të jemi të mobilizuar të gjithë.

Ajo u ngrit në këmbë, uli sytë dhe kopsiti bluzën me lëvizjet e ngathëta të gishtrinjve që i dridheshin nga emocioni. «Sikur të vijë dhe ai në ndeshje, — mendoi shpejt, — sa mirë do të ishte!» Pastaj mori frymë thellë dhe, sikur të fliste me zemër në dorë, tha:

— Oh, profesor! Unë do të luaj si gjithmonë, — dhe u fut midis vajzave që ishin bërë gati të zbrisnin.

Traineri tundi kokën lehtë i habitur, si të donte të shkoqiste me vete domethënjen e fjalëve të saj dhe u mat t'i thoshte diçka. Por Afërdita tani ishte duke ecur e shkujdesur përmes vagonit, midis shoqeve të skuadrës së saj.

MËSUESI I FISKULTURËS

Mësuesi i fiskulturës e shtyu derën e madhe të shkollës, eci me hapa të ngadalshme në korridor dhe e hodhi vështrimin te tabela ku vendosen fletërrufetë. Një ditë më parë ai kishte lexuar fletërrufenë që kishin vënë nxënësit e maturës për të. Në jetë nuk i kishte qëlluar të lexonte shkrim më shqetësues... Nxitoi, u fut në dhomën e tij ngjitur me sallën e gjimnastikës dhe, si një mekanizëm, hoqi kostumin e veshë tutat.

Tërë natën nuk kishte vënë gjumë në sy, po kishte sjellë nëpër mendje gjithfarë mendimesh, që sa bënte t'i harronte, ato i ngatërroheshin dhe atëhere i faniteshin në sy gërmat e mëdha të fletërrufesë.

Mësuesi mbeti në këmbë i menduar. Disa herë ai kishte dashur të kontrollonte veprimet e veta. Po nuk kishte pasur kurajo.

— Po nxënësit e tjerë vallë ç'mendojnë për mua? — murmuriti lehtë. Pasi u ul në karrige, i vuri të dy brrylet mbi tavolinë, mbështeti mjekrën në mes të pëllëmbëve të hapura dhe ndenji si i përgjumur, gjer-sa ju bë se jashtë nxënësit e klasës së maturës po lexonin fletërrufenë me zë të lartë: «— Ju, shoku mësues, nuk keni dashuri për profesionin tuaj...»

Mësuesi mblodhi buzët, siç bën çdo njeri kur provon një pije të hidhur.

«— Pse këndin sportiv dhe sallën e gjimnastikës i keni lënë në atë gjendje, siç kanë qenë vjete më parë?»

— Vërtet ashtu, — foli me vete, — këndi, salla — dhe u ngrit nga karrigja, hapi derën që komunikonte me sallën, dhe i hodhi asaj një vështrim të gjatë. Salla ishte pothuajse bosh. Në një faqe muri qenë vendosur një çift shkallësh suedeze të vjetëruara. Përballë tyre, në qoshe, pushonte një kaluç. Sipër tij qenë palosur nja dy-tre dyshekë. Lart, nga tavani, qenë varur si dy gërsheta të gjatë dy litarë. Litarët shërbenin për unaza. Po vetë unazat mungonin. Litarët ishin ngritur pak lart që nxënësit mos të kishin mundësi t'i kapnin, as me kërcim. Nëpër mure ishin varur aty këtu ca foto-grafi sportive dhe dy parulla. Mësuesi ndjeu se salla ishte e zbratur dhe e ftohtë. Vështrimin e tij të singurtë dhe hetues e ndali diku nga fundi i sallës dhe ju bë se atje pa veten e tij. Sa ngjante ai me këtë sallë! Ajo i shërbente sa për të bërë orën e mësimit, ndërsa ai vetë shërbente sa për të marrë rrogën. I erdhi rëndë nga kjo.

Donte t'i shmangej këtij dyluftimi me ndërgjegjen, po nuk ishte punë e lehtë. Atëhere e ndjeu përsëri zërin e fortë të maturantëve:

« — Për gjimnastikën e mëngjezit s'e keni çarë fare kokën».

— Ashtu ka qenë, — belbëzoi dhe solli ndër mend se nxënësi që kishte caktuar për të zhvilluar gjimnastikën e mëngjezit që ankuar disa herë:

« — Nuk bëhet në rregull» — i thoshte ai. Dhe ca ditë më parë kishte shtuar: «Nxënësit sikur s'duan të më binden, sidomos ata të maturës».

Përsëri ai ndjeu se nëpër xhamat e thyer vinte zëri i fortë i nxënësve. Dhe i erdhi inat me veten që xhamat e thyer nuk i kishte zëvendësuar me të rinj.

« — Me nxënësit silleni me kokëfortësi dhe kërkoni të mbani distancë. Dje u treguat edhe kapriçioz. . . »

— Vërtet ashtu, — dhe ai ndjeu mornicat që i përshkuan tërë trupin. Ç'kishte ndodhur dje? Ju kujtua gjithshka. . .

...Ai kishte qëndruar te dritarja, pranë sobës së ndezur dhe shikonte përjashta. Qielli ishte ngarkuar me re të përhimta. Frynte një erë e ftohtë që lëpihej nëpër xhama. Ai priste nxënësit për të filluar orën e mësimit. Nisi të bjerë një shi i imët. Nxënësit që kishin mësim, me kujdestarin në krye u futën në dhomën e zhveshjes. Mësuesi i pa me bisht të syrit.

« — Qenkan ata të maturës që s'rrinë mirë në gjimnastikën e mëngjezit », — mendoi dhe u afrua.

— Ç'prisni? Zhvishuni! Të më paraqiteni në mësim me të mbathura e kanotiere — u shfryu atyre.

— Si? — thanë ata njëherësh. — Po sot është shumë ftohtë.

— I lini fjalët. Zhvishuni, — dhe shkoi në dhomën e tij tërë inat.

Pas tij hyri nxënësi kujdestar.

— Po ti akoma s'je zhveshur?

— Jo, shoku mësues. Sot është shumë ftohtë. Juve vetë na keni thënë se në periudhën e dimrit gjimnastikën do ta bëjmë me tuta. Pastaj palestra e ka dyshtemenë me çimento. Shumë xhama i ka të thyer.

— Si? Për dyshtemenë që s'e keni me parket shkoni dhe ankohuni te drejtori. Për xhamat s'keni se ç'të thoni. Vetë i keni thyer.

— Po...

— S'ka po e jo këtu! Mos e zgjatni më. Po kalojnë minutat pa bërë mësim.

Nxënësi kujdestar doli dhe shkoi te shokët. Mësuesi mbeti përsëri vetëm.

— Kështu e duan këta, — murmuriti.

Nxënësi kujdestar u kthye prapë:

— Nuk zhvishen. «Mësuesi e bën për kapriçio», — thonë ata. Kështu them dhe unë.

— Ashtu, ë, — murmuriti mësuesi nëpër dhëmbë dhe u drejtua nga nxënësit. — Kush do të bëjë mësim, le të zhvishet. Të tjerët, kokëfortët, marsh, të dalin përjashta dhe të shkojnë te drejtori! — Ai u ktheu shpinën dhe bëri sikur po rregullonte dyshekët që qenë sipër kalucit. Priti e pritë që nxënësit të hynin një nga një kokulur prapa tij, po ata nuk po dukeshin. Ashtu siç qenë, duke pëshpëritur, u larguan nga dhoma e zhveshjes. Mësuesi mbeti si i ngrirë.

Tani atij ju bë sikur ata që kishin ikur dje ashtu, vazhdonin të thërrisnin që përjashta:

« — Shumë pak interesoheni për kampionatet midis klasave».

« — Në kampionatet midis shkollave, shkollajonë radhitet nga fundi».

« — Ju, shoku mësues, duhet të bëni kthesë!»

« — Juve jeni një sportist i mirë. Bëhuni edhe një mësues i mirë... »

Në oborrin e shkollës tingëlloi zilja. Në veshët e mësuesit të fiskulturës, që kishte mbetur i topitur me shpatulla të mbështetura te muri, ajo erdhi me ca tinguj të dobët, që mezi i kapte veshi. Më vonë tingujt erdhën e u bënë më të fortë, aq sa ju duk se ajo binte vetëm për të, se ajo e thërriste të dilte në shesh para nxënësve, për të drejtuar gjimnastikën. Kur doli,

vuri re se nxënësit, megjithëse nxiteshin nga mësuesit, lëviznin si të mpirë. Pastaj ata dalëngadalë zunë vendet nëpër rreshta. Ai hipi mbi një stol që të komandonte ushtrimet.

— Fillojmë, — tha. — Ju andej nga mesi e nga fundi rrini më mirë në rresht. Gati për ushtrim. Krahët para, një, — thirri me të madhe dhe i erdhi rëndë që thirri aq fort. — Dy, — dhe prapë i erdhi rëndë nga vetja. — Tre, katër... — Fliste dhe diçka sillte në mendje...

... Qysh në moshë të re ishte marrë me sport. Në shkollë kishte qenë nga më të shkathëtit. Shpesh dëgjonte që pëshpëritej rreth tij: «Do të bëhet një sportist i mirë». Pastaj i doli bursa për në teknikumin e fiskulturës dhe, kur e mbaroi, ishte bërë një sportist i mirë.

— Ushtrimi tjetër. Duart mbi supe, një. Rrethrotullim... — dhe nxënësit lëvizën...

Profesioni i mësuesit në fillim i pëlqeu. Nxënësit e donin. Mësimin e bënte në oborrin e shkollës, ku kishte një kënd sportiv të pajisur me modesti, me mjetet e nevojshme sportive. Brenda, në sallën e gjimnastikës, mësimi i shkonte mirë, aq sa e ndjente se, kur binte zilja, e cila lajmëronte mbarimin e orës së mësimit, nxënësve nuk u vinte mirë. Ai gëzohej për profesionin që kishte zgjedhur. I bëhej se kishte zgjedhur profesionin më të mirë e më të përshtatshëm. Kështu kaluan vitet e para...

— Hej, ti atje, mos e ngacmo shokun. Me kërcim, këmbët anash, një, përkulje përpara, dy, thellëthyemje, tre, shtytje prapa, katër... Një, dy, tre...

... Më pas e emëruan në një kategori shkollë më të lartë. Kjo në fillim e gëzoi. Por shpejt ishte shkëputur nga fijet e gëzimit që ndjeu. Tani ai do

të kishte të bënte me nxënës më të rritur. Duhej punë më e madhe. Nxënësit, me pjekurinë e tyre, arrijnë të gjejnë se sa vlen. S'mund t'i gënjesh më me ato lodrat e shkathëta.

— Ej, ti atje që s'po vë mend, dil nga rreshti. Kujdes të tjerët.

... Shkolla ku ishte caktuar, këndin sportiv e kishte të varfër. Sallën për të zhvilluar mësimin brenda nuk e kishte në rregull. Mësuesi, që kishte dhënë fiskulturën përpara tij, kishte bërë ca përçapje dhe kishte mundur të siguronte një farë salle, të cilën nxënësit e quanin palestër. Ajo duhej rregulluar e plotësuar me mjete sportive.

— Ej, ju atje nga fundi, pse më rrini si të ngrirë? Lëvizni. Ushtrimi tjetër: dorën e majtë grusht sipër kokës, një, të djathtën poshtë, dy...

... Duhej nisur nga e para. Atëhere kishte vendosur të rregullonte këndin dhe sallën. I kishte treguar drejtorit planin e tij të punës, por ky ishte tërhequr.

— Duhet fonde, është viti i kursimeve, — i kishte thënë drejtori. — Lëri këto gjëra të tepërta. Puno dhe ti si mësuesi i parë. Ne s'kërkojmë më tepër nga ç'ka bërë ai.

Dhe mësuesi i ri ishte thyer.

— Hej, ju atje nga fundi, i lini pëshpëritjet. Një, dy...

... E pati shtruar edhe në këshillin pedagogjik planin e punës. Po si për çudi dhe atje e dëgjuan ftohtë. Mësuesit kishin heshtur. Disa ishin mësuar të mbajnin anën e drejtorit. Duke dalë nga mbledhja, një mësues i kishte thënë:

Ç'ke për të bërë, mundohu ta bësh vetë. Mos prit nga ne të të ndihmojmë. Ti s'na ndihmon dot

në lëndët tona. Edhe ne s'të ndihmojmë dot. Secili duhet të mësohet ta mbajë vetë peshën e profesionit të tij...

— Një, dy, tre, katër, — dhe nxënësit vazhdonin ushtrimet e zakonshme që i kishin bërë me dhjetëra e qindra herë...

...«Pesha e profesionit!» — kishte menduar ai atëhere. Ç'do të thoshte kjo? Dhe për të parën herë nisi ta peshojë veten me miligramët e së vërtetës. Ai punonte në shkollë si mësues, merrej me sport, ishte trainer i një skuadre të rinjsh dhe ndiqte Institutin e lartë me korrespondencë. Ai po bindej se kolegu i tij kishte pasur të drejtë. «Duhet të shkarkohem disi, — i kishte thënë vetes. — Po nga?»

Sportin e kishte pasion. Edhe detyrën e trainerit s'mund ta linte. Skuadra e tij kishte dhënë rezultate të mira dhe, për më tepër, ai paguhej për orët që bënte. Atëhere të linte institutin! Jo, këtë e nisi dhe s'mund ta linte përgjysmë. Ai do t'i duhej për të ardhmen. Atëhere detyra si mësues! Po, këtu ai mund të shkarkohej pak.

— Më shpejt, më shpejt, tre, katër. Majtas, djathtas, tre, katër. Para, prapa, tre...

...Për gjimnastikën e mëngjezit caktoi një nxënës të shkathët. Kështu e hiqte qafe ardhjen herët në shkollë. Pastaj vinte ora e mësimi. Këtu e kishte punën vetë në dorë. E vërtiste si të donte. Po ta ndjente veten të lodhur, ose që të mos lodhesh, u nxirrte nxënësve topin dhe u organizonte lojra. Vetë rrinte e shikonte si spektator. Përsa u përket aktiviteteve sportive brenda dhe jashtë shkollës, këtë e linte krejt në dorë të këshillit sportiv të nxënësve. Ai mjaftohej vetëm duke dhënë udhëzime. Kështu kaluan vitet...

— Kapuni për dore dy e nga dy. E tërhiqni fort

njëri-tjetrin përpara. Hajde fort, më fort... Ej, ju atje. Dhe ju atje lëvizni. — Por nxënësit shpejtuan dhe u shpërndanë, pa i përfillur fare qortimet e mësuesit të fiskulturës. Pikat e mëdha të shiut u derdhën mbi kokat e tyre me furi dhe ata u shpërndanë.

* * *

Në korridorin e shkollës kishte lëvizje të madhe. Nxënësit ecnin, afroheshin, lexonin me kujdes, siç lexohen zakonisht fletërrufetë, dhe pëshpërisnin me njëri-tjetrin.

Mësuesi i fiskulturës shpejtoi hapat, përshkoi korridorin dhe u fut në sallën e mësuesve. Mësuesit që sapo ishin kthyer nga gjimnastika, i lanë bisedat dhe heshtën për një çast. Ai hodhi një vështrim rreth e qark, po drejtori nuk ishte aty. Doli dhe bëri nga drejtorja. Kaloi pranë grupit të nxënësve që po lexonin me kureshtje fletërrufenë dhe kalimthi nguli sytë e lexoi:

«Mësuesit të fiskulturës. . .» S'pati kurajo të lexonte më tutje, po shpejtoi hapat e trokiti në derën e drejtorisë. S'mori përgjegje. Punëtorja e shërbimit, një grua gjysmë e thyer në moshë, ju afrua pranë dhe i foli me zërin e saj të ngrohtë, si të një nëne:


— Nuk është aty. Ka shkuar në klasën e maturës. Po bën mbledhje me nxënësit.

Mësuesi, pa thënë gjë, i hodhi një shikim dashamirës.

— Po ta doni, shkoj dhe e thërres, — tha prapë ajo.

— Jo. Do shkoj vetë atje.

Dhe ashtu bëri. Eci nëpër korridor dhe, kur ju



afrua pranë grumbullit të nxënësve, të cilët po lexonin fletërrufenë, desh të ndalej. Të ndalej dhe t'u thoshte atyre vetëm një fjalë. Vetëm «e meritoj». Po edhe këtë herë s'u dha.

Nxënësit e vunë re mësuesin dhe u hapën në dy rreshta për t'i bërë rrugë. Ai kaloi para tyre syzullur. Atëhere njëri prej tyre tha:

— E kanë tepruar ata të maturës.

Mësuesi u kthye, ju afrua atij që foli, i hodhi dorën në qafë dhe tha:

— Jo, Ardian, unë e kam tepruar, — dhe eci bashkë me të.

Nxënësit ju afruan mësuesit përreth dhe kush në krah të majtë, kush në të djathtë e kush prapa, përshkuan korridorin që të shpinte te klasa e maturës. Ata ecnin me të dhe atëhere mësuesi ndjeu se akoma e donin dhe se dashuria e tyre për të ishte posi thëngjilli që duhet t'i frysh e t'i frysh, gjersa të ndizet mirë e të bëhet flakë.

FITORJA E NADIRIT

Llamba e vajgurit përhapte dritë të verdhë mbas muret e dhomës së vogël, mbi sendet rretheqark dhe mbi fytyrat e shqetësuara të katër të rinjve, anëtarë të njësitit gueril të qytetit. U hap dera dhe drita e verdhë ndriçoi edhe fytyrën me sy të merakosur të nënë Fatimesë.

— U bë shumë vonë, — tha ajo, — dhe do ta keni pisk kur të dilni.

Të katër djelmoshat vështruan njëri-tjetrin.

— Atëhere, kështu si e lamë, — tha me zë të ulët Fatmiri, që tregonte pak më i rritur se të tjerët. — Tani të dalim një nga një.

Pas pak në dhomën e vogël mbeti vetëm Nadiri, djali i vetëm i nënë Fatimesë. I shtrirë në minder, ai mendohej të ishte i qetë. Nënë Fatimeja hyri prapë në dhomë, po kësaj radhe për t'i sjellë darkën të birit. Që në vështrimin e parë ajo e kuptoi se Nadiri kishte rënë në mendime. «Do t'i kenë ngarkuar ndonjë detyrë të rëndë për të kryer», — mendoi. Mori stolin e vogël në qoshe, e afroi pranë minderit dhe vuri në të tepsinë e vogël të bukës. Nadiri ishte kthyer nga ajo. Ai i hodhi një shikim të ftohtë tepsisë dhe u pështet përsëri në minder. Nënës i theri në zemër: «Ç'do t'i bëjë kjo copë bukë?... Mosha dhe trupi i tij duan

ushqyer ndryshe», — mendoj dhe i lidhi duart përpara futasë.

— Si harrova të të sjell edhe një gotë çaj, — tha shpejt e shpejt dhe u ngrit të shkojë.

— Lëre nënë, lëre, — i tha Nadiri. — Për sonte mjafton vetëm fërgesa.

Ajo u kthye, eci ngadalë dhe u ul pranë tij. Nadiri, për t'i bërë qejfin nënës, nisi të hajë me oreks.

— Pse u mblodhët prapë sonte? — e pyeti ajo.

— Unë kisha menduar se do të mblidheshim për Niazi Belukën, i cili, si spiun i regjur, na ka sjellë shumë telashe, por Fatmiri na paraqiti një plan tjetër...

Nëna ngriti pak sytë dhe e pa Nadirin drejt, si për ta pyetur: «Për çfarë?»

— Po ja, — vazhdoi Nadiri, — ata kanë sjellë nga Italia një ushtar që është edhe mundës. Ai do të stërvisë shokët e tij dhe do të ndeshet edhe me ne.

Nënë Fatimeja vazhdonte të qëndronte e heshtur, pa mundur të kuptonte mirë domethënjen e fjalëve të të birit.

— Dhe ne vendosëm që t'i japim një mësim të mirë, po të na eci mbarë. Do të ndeshemi me mundësin që ka ardhur nga Italia.

Nëna mblodhi buzët. S'i erdhi mirë që do të ndesheshin me italianët.

— Po ndeshjen pse do ta bëni, që ta keni më të lehtë për të kryer aksionin? — pyeti me zë të pakët ajo.

— Jo nënë, këtë radhë jo. Armikun mund ta godasim edhe moralisht, — nguli këmbë ai. — Pastaj ata sikur kanë rënë në erë që, sa herë organizojmë takime me ta, do kryhet ndonjë aksion. Ndaj kanë filluar të marrin masa.

— Mirë e ke thënë! Po ju, a jeni të sigurtë se do ta mundni italianin?

Nadiri uli sytë i menduar dhe ndenji ashtu një copë herë. Pastaj ngriti kokën dhe tha ca fjalë gjysma-gjysma:

— Po, si ta them. . . Tani. . . kjo varet. Sport është. . . Po, ama, fashisti duhet mundur nënë, duhet mundur patjetër!

Nëna e pikasi shpejt shqetësimin e të birit dhe i ndritën bebet e syve. Vështrimi i shastisur i saj mbeti gjatë mbi fytyrën burrërore të Nadirit.

— Kush nguli këmbë për ndeshje me zaptuesit? — pyeti pas pak ajo, duke i dhënë jetë zërit të saj.

— Fatmiri.

— Epo mirë atëhere.

Nadirit i erdhi mirë që dhe nëna e miratoi mendimin e shokëve, por i mbeti peng që ajo shprehu pak dyshim në fjalët që tha.

— Po ti, nënë, sikur s'ke shumë besim te unë!

— Besim, the? Oh, Nadir, si mos të kem besim! Pse, i pakët je ti? Mashallah, shtatin tënd s'e ka tjetër kush në moshën tënde. . . Po s'kam dhe si ta fsheh, Nadir! Ata që e kanë sjellë që përtej detit, me sa duket i kanë bërë hesapet mirë. Duhet të jetë i mësuar dhe i mësuar mirë. . .

Nadiri heshti, si të donte të merrte me mend se sa i mësuar mund të ishte mundësi italian, që do të ndeshje me të. Kjo e stepi pak, por në sytë e nënës së përvojtur s'deshi të jepej.

— Edhe ushtria e tyre e mësuar është, po, ama, kur i zë belaja, s'dinë ku të fusin kokën, — tha ai.

Nëna u mundua të buzëqeshë. Asaj i erdhi mirë që djali i saj kishte besim te vetja. «Dhe shokët duhet të kenë besim», — mendoi dhe mori tepsinë e bukës

e doli, duke e çuar përsëri mendjen te italiani që e kishin sjellë që përtej detit.

Nadiri qëndroi gjatë i shtrirë në minder duke menduar për italianin me të cilin do të ndeshej. Nga do që e kapte fillin e mendimeve, arrinte në përfundimin se ndeshja e ardhshme ishte filli më i ngatërruar i jetës së tij.

«Eh, nënë — foli me vete Nadiri, — punë e ngatërruar. Të më kishin caktuar për ta zhdukur, do ta kisha më të lehtë. Po kështu?» — dhe u ngrit të rregullojë krevatin.

Më pas ai solli ndër mend rastet kur kapesh befas me shokët, në mësimin e fiskulturës dhe fushës me bar kur delnin në piknik. Përherë i kishte vënë poshtë shokët. Vetëm Arianin jo. Arianin e shëndetshëm dhe të zhdërvjellët, i cili ndihmonte xha Hamdiun të frynte topat e të vizonte fushën, e solli në palestër mësuesi i fiskulturës. Ata të dy e përballuan gjatë njëri-tjetrit, gjersa mësuesi e ndërpreu dyluftimin dhe e përgëzoi Nadirin përpara shokëve të klasës duke i thënë: «Të lumtë Nadir! Ariani është një djalosh i mësuar, por s'mundi të të rrëzojë dot me shpatulla». Atëhere ai dhe shokët e tij kishin parë nga Ariani, i cili, duke dihatur thellë, u vesh shpejt e doli kokulur. Dhe mësuesi s'kishte thënë kot për Arianin se ishte djalë i mësuar. Ai, që e kalonte gjithë ditën pranë fushës e palestrës së Shallvares, shikonte ushtarët italianë që vinin të bënin boks dhe mundje. Bile thoshin se si ishte kapur me ta.

«Pse s'u fola shokëve për të, — mendoj Nadiri. — Jo, Jo, më mirë që s'u fola. . . Shokët do të mendonin se jam burracak. Pastaj, Ariani është bashkuar me partizanët e çetës së Dajtit. . .»

Nadiri rrinte shtrirë, po gjumi s'po e zinte. Ai

e kishte qetësuar nënën, duke i thënë se «nga shtati jemi aty-aty», po vetë akoma s'e kishte parë italianin me të cilin do të ndeshëj. «Nesër do të shkoj ta shoh në palestër», — mendoi dhe ju ngroh zemra kur kujtoi, se s'do të bënte keq të shkonte të takonte edhe mësuesin e fiskulturës...

* * *

Salla e hapur e kinema «Donikës» nuk kishte mbledhur ndonjëherë tjetër kaq shumë njerëz si atë ditë që do të zhvillohej mundja ndërmjet italianit Xhuzepe Frau dhe të riut tiranas Nadir Mushqeta. Nëpër bulevardet kryesore ishin vënë shumë afishe; me urdhër të vetë prefektit kjo ndeshje e bujshme u reklamua edhe me radio, prandaj kishin ardhur kaq shumë njerëz.

Paria e qytetit, me gjeneralin e ushtrisë italiane e prefektin në mes, zunë vend në radhët e para. Në fytyrat u endej një fije gëzimi. I bënte të buzëqeshte numri i madh i njerëzve që ishin mbledhur. Para syve të tyre do të demonstrohej teknika e një sporti që në Shqipëri ishte i përhapur, por që nuk zhvillohej ashtu siç duhej; po edhe këtu, me ndërhyrjen e shkollës italiane, do të merrte rrugën e mbarë. Tek hidhnin sytë përreth, ata vështronin djelmosha që shtyheshin, të tjerë që kishin hipur mbi muret e degët e trasha të plepave, të cilët rrethonin kinemanë. Edhe dritaret e shtëpive aty pranë ishin mbushur me njerëz.

— Kështu, shumë mirë, — i tha me përzemërsi gjenerali prefektit. — Të kishim t'i mblidhnim përherë kështu!

— Të mendojmë për ndeshje të tjera, — u për-

gjegj shpejt prefekti dhe, në çast, një ndjenjë e zymtë e bëri të dridhet. «Shumë, shumë kanë ardhur, — mendoi me ankth, — më shumë nga ç'e kisha menduar» dhe ju duk se djelmoshat që shtyheshin, ata që qëndronin mbi mure e në degët e plepave, e vështrojnë me zemërim, sikur të ishin gati që me shenjën e parë t'i hidheshin përsipër.

— Shumë. . . — murmuriti prefekti.

— Shumë mirë, shumë mirë, — tha gjenerali, që ishte i bindur se në rreshtat prapa krahëve kishin zënë vend ushtarët e tij.

U dëgjuan ca duartrokitje të lehta. Ushtarët italianë përshëndetën daljen e çiftit të parë në skenë. Ishin dy italianë trupvegjël që do të hapnin serinë e ndeshjeve miqësore. Ndeshja e tyre, si dhe ajo e çiftit të dytë e të tretë, ishin si ato këngët që jep alto-parlanti i kinemasë para se të fillojë filmi.

Kur erdhi radha të dilnin në tapet Nadiri me Xhuzepen, ndeshja e të cilëve kishte ngjallur kaq shumë interes, salla i la pëshpëritjet dhe i mbërtheu vështrimet te skena. I pari doli Xhuzepe. Ushtarët dhe ata që qëndronin rreth gjeneralit e prefektit duartrokitën me ngrohtësi. Pak pas tij doli Nadiri. Një çast u duk se nga plepat e lartë fluturuan e rrahën krahët fort mijëra pëllumba. Pastaj duartrokitjet u pasuan nga të thirrurat e forta, që kërkonin t'i jepnin zemër Nadirit qysh në fillim. Ndërkaq gjenerali dhe ushtarët buzëqeshën lehtë, si të donin të thoshin: «Thirrje kalamajsh.» Vetëm prefekti, si të vazhdonte të ndiqte më me ankth zymtësinë e ndjenjës që kishte provuar pak më parë, s'ja ndante sytë për asnjë çast tapetit ku do të zhvillohej ndeshja.

Arbitri, një mësues fiskulture që e kishte kryer shkollën në Itali, hipi në skenë, u dha dorën dy mun-

dësve dhe i afroi ata në rrethin e vogël të tapetit. Mësuesi i fiskulturës që kishte mësuar Nadirin, dhe Fatmiri, njëri prej të cilëve luante rolin e trainerit dhe tjetri të sekondantit, i hoqën Nadirit peshqirin e madh nga shpatullat dhe i fërkuan lehtë tëmthat. Mësuesi i foli qetë-qetë:

— Merre shtruar, si atëhere në Shallvare. Dhe shoku yt, Ariani, që i mësuar, por ti e bëre të dalë nga palestra kokulur.

— Fitoren tënde e kërkojnë të gjithë, — i tha Fatmiri i vendosur. — Po t'u dha rasti, përmbli dhe mirë, shqiptarçe. Mos harro për asnjë çast se këtu kanë ardhur të gjithë shokët tanë; edhe ata të qarkorit.

Nadiri shtrydhi krahët dhe, si ta ndjente veten më të fortë nga fjalët e mësuesit dhe të Fatmirit, u kthye shpejt dhe ju afrua rrethit të vogël. Fishkëlleu bilbili i arbitrit dhe ndeshja filloi. Në fillim italiani e ndjente veten më të sigurtë. Ndërhyrjet dhe lëvizjet e tij ishin të matura dhe kapjet të shkathëta e të zgjuara. Nadiri, me muskuj të tendosur, i largonte me forcë krahët e tij dhe e shtynte përpara kundër-shtarin. «Kërkon të më mashtrtojë», — mendoi ai kur italiani i zgjaste njërin krah përpara, si për t'i thënë: «Hë, kape!» Nadiri ja largonte krahun me nervozizëm.

— Ashtu, Nadir! — shpërthyen thirrjet e shumta të shokëve, si të donin të thoshin: «More vesh, mos e ha atë kokërr ulliri që do të të japë!» Kaluan kështu minutat e para. Ushtarët nisën të vërshëllejnë. Edhe gjeneralit s'ju ndenj pa lëvizur. Ai u kthye një herë nga ushtarët e tij, të cilët, të ngritur në këmbë, thërrisnin:

— Ej, Xhuzepe, ç'po bën kështu! — dhe, pasi vrejti vetullat, drejtoi trupin përpara dhe i mbërtheu duart me forcë te rripi i trashë i uniformës. Prefekti

sikur s'donte t'ja dinte dhe aq për fishkëllimat. Me sa dukej, ai parandjente diçka të zymtë, që ishte kundër dëshirës dhe vullnetit të tij.

Arbitri e ndërpreu ndeshjen dhe me një ton të ftohtë u foli si pa qejf të dy mundësve. Xhuzepja murmuriti diçka në inat e sipër, kurse Nadiri qëndronte në këmbë, i vendosur për t'u mbrojtur dhe për të pritur çastin. . .

«Nuk duhet të mposhtem në asnjë mënyrë!» — tha me vete dhe, ndërsa arbitri jepte e merrte me ta, atij i shkoi mendja te shokët, të cilët, disa metra larg, shikonin të shqetësuar; i shkoi mendja te nëna që e hante meraku duke pritur në shtëpi, dhe te Ariani e shokët e tij të çetës. . . Arbitri i fryu bilbilit si të donte të thoshte: «Ej, a erdhët në vete të kapeni siç duhet?»

Xhuzepja, si të kishte ndjerë thellë shqetësimin e shokëve të vet ushtarë, u fut rrëmbyer, kapi krahët e Nadirit me forcë, harxhoi një energji të madhe gjersa i hapi anash dhe i mbërtheu me inat belin. Në çast u ndërpreu fishkëllimat dhe vendin e tyre e zunë britmat e gëzuara:

«Bravo Xhuzepe! Forca Xhuzepe!»

Por Nadiri, si të mos i duronte ato, e përmbloodhi kundërshtarin për beli. Disa çaste ata mbetën të dy të mbërthyer, me krahët e lidhur te trupi i njëri-tjetrit. . . Në sallën verore, në muret e degët e në plepat e lartë u shuan britmat dhe heshtja e padukshme zuri vend kudo. Qindra sy u fiksuan te të dy mundësit, të cilët, në këto çaste, s'bënin gjë tjetër, veçse qëndronin palëvizur, duke tendosur muskujt e këmbëve në tapetin e butë, si të donin të merrnin forcë prej tij. Pastaj, ata shtrënguan krahët fort dhe trupat e tyre nisën të drejtoheshin pak nga pak. Njerëzit lëvi-

zën nga vendi, zgjatën kokat për të bindur më mirë veten se kush nga të dy mundësit e kishte kapur më mirë dhe më me forcë belin e kundështarit. Mundësit përsëri u përkulën në gjunjë, duke lëvizur nga pak këmbët, si të donin të tregonin se prova e parë mbaroi pa sukses dhe tani po përgatiteshin për të dytën.

Nadirit s'i erdhi mirë që shokët i ndërprejnë britmat. Ai e ndjente se heshtja e tyre ishte vuajtje për ta.

Ndërkaq italianin u mundua ta tërhiqte nga e djathta e tij, por Nadiri s'ju dha. U dëgjuan thirrjet.

— Forca, Xhuzepë! — dhe Nadiri e kuptoi se italianin po mundohej të bënte diçka që të gëzonte ushtarët që thërrisnin me ngulm. Ai ktheu kokën nga mësuesi dhe nga Fatmiri. Të dy ata kishin mbledhur duart grusht, si të donin të thoshin: «Përmbli dhe dhe një herë. . .» Fatmiri ktheu kokën dhe me fytyrë të vrenjtur pa nga salla, që t'u jepte të kuptonin të gjithëve se u duhej mbyllur goja fashistëve. Kur e ktheu përsëri vështrimin nga tapeti, ai u shtang. Me një veprim të shpejtë, Nadiri e mbërtheu edhe një herë kundërshtarin për beli dhe nisi ta shtrëngojë përherë e më fort. . .

«Fashist! — mendoj Nadiri kur pa se ai po mundohej të shtrëngonte krahët, që të mbrohej së në rastin e parë. — Tani zor se më shpëton».

Salla ushtoi nga zërat e shumtë që donin ta shihnin Xhuzepen me shpatulla përtokë.

Italianët vjedhurazi shikonin njëri-tjetrin, si të donin të pyesnin: «Po tani çdo të ndodhë?!»

Ndërkohë shokët e Nadirit bërtisnin me të madhe: — Merrja shpirtin!

Ushtarët, gjenerali, prefekti dhe paria shtrëngonin dhëmbët, duke e hedhur vështrimin nga tapeti.

Dalëngadalë trupi i Xhuzepes po lakohej përherë e më shumë dhe ai nisi të përplasë këmbët në ajër, si njeriu që, në çastin kur është duke u mbytur, kërkon me dëshpërim të prekë tokën me majat e këmbëve. Arbitri, një njeri që i qante zemra për Italinë, i fryu bilbilit. Salla, si të ishte një sirenë, fishkëlleu njëherësh. Ushtarët ulën kokën. Nga të katër anët tani dëgjoheshin thirrjet:


— Mos e lësho, Nadir! Këpute në mes!

Nadiri vazhdonte ta shtrëngonte dhe, kur pa se kundërshtari s'kishte më forca të mbrohej, e tërhoqi fort pas vetes dhe e hodhi në dyshekët e tapetit.

Xhuzepja, si një kafshë e plagosur, u përplas keqas. Kjo që po ndodhte ishte gjëja më e mjeruar e karrierës së tij si mundës. Ai përmbloodhi veten dhe u mundua të ngrihej. Në fytyrën e tij, si te ajo e një të sëmuri me temperaturë të lartë, shpërthyen bulëza djerse. Dihaste dhe shtrëngonte nofullat nga dhembja që ndjente në brinjë. Mbështeti njerin gju në dyshek dhe u dha krahëve fort që të kishte mundësi të ngrihej sa më shpejt. Kuptohej qartë se kjo gjendje e torturonte shumë. Nadiri priste që kundërshtari të ngrihej mirë në këmbë dhe pastaj të kapeshin prapë. Tani njerëzit e shumtë s'përmbaheshin dot. Disa nga shokët e Nadirit ju afruan podiumit dhe, duke u grindur me karabinierët që mundoheshin t'i pengonin, thërrisnin fort duke ngritur grushtat lart:

— Mbërtheje dhe një herë!

Arbitri shtangu në vend, duke e vështruar Nadirin si të donte të gjente arsënyen që e shtynte të mos i hidhej kundërshtarit sipër, kur gjendej i shtrirë në tapet. Nadiri u kthye prapë nga mësuesi e nga Fatmiri, si t'u thoshte: «E, e kam mirë kështu?» Fatmiri i ndritën sytë nga gëzimi dhe krenaria. Ai nxori dorën



para, e mblodhi grusht dhe e tundi dy-tri herë. Me të desh të thoshte: «Kështu na ka hije më tepër fitorja».

Gjeneralit dhe ushtarëve italianë u kish rënë një gehre e pikëlluar në fytyrë. Mënyra se si rrinin nëpër vende shprehte haptazi dëshirën e tyre që kjo ndeshje, sido që ta kishte përfundimin, të mbaronte sa më shpejt. Tek shihnin gëzimin e papërmbajtur të njerëzve dhe tek dëgjonin thirrjet e tyre, ata e ndjenin se u kishte plasur bomba në dorë. Tani ishte e qartë për të gjithë se italiani Xhuzepe s'kishte më shpresa për fitore. Sapo u ngrit nga tapeti, ai i mblodhi forcat dhe u mundua të kryente një lloj kapje «krahëqafë». Po Nadiri e mbërtheu dhe një herë për mesi, e ngriti lart dhe nisi ta shtrëngojë... Trupi i Xhuzepes këtë radhë u lakua shpejt. Fytyra e tij u mbush gjithë rrudha nga dhembja. Nofullat i mban-te të shtrënguara fort, ndërsa sytë i kërcyen jashtë, si të ishin gati t'i dilnin nga zgavrat. Një çast koka e tij, si koka e një të sëmuri që s'e duron më dhembjen, u var te supi i Nadirit. Arbitri kuptoi gjithshka. Ai i fryu disa herë bilbilit dhe me duart që i dridheshin nga nervozizmi bëri shenjë që ndeshja të ndërpritej. Atëhere buçitën përsëri britmat e papërmbajtura dhe fishkëllimat kundër arbitrit, i cili kërkonte të ndihmonte mundësin italian.

Nadiri s'e lëshonte kundërshtarin. Vetëm kur Xhuzepja bërtiti me të madhe «O zoti im», dhe, duke tundur këmbët në ajër i hodhi Nadirit duart në fyt, atëhere e çliroi nga krahët e vet të fuqishëm, duke e përplasur me neveri në dyshekët e tapetit. Xhuzepja u shemb më keqas se herën e parë. Pastaj, si të qe shurdhuar nga britmat e forta të njerëzve që tani ishin afruar shumë, vuri duart në veshë, ndenji ca

çaste ashtu me kokën ulur dhe, kur ndjeu se dikush e kapi për krahu, u ngrit me mundim. Duke vënë duart te brinjët, ai eci ngadalë, duke u mbështetur te supi i arbitrit, gjersa u fut te dhoma e zhveshjes.

Ë pari që e përqafoi Nadirin qe Fatmiri.

— Oh, ç'ja bëre mirë! — i tha duke e pushtuar fort nga krahet. — Ama ja bëre brinjët copë. . .

Ndërkaq, gjithë shokët e Nadirit hipën në skenë dhe nisën ta urojnë për fitoren. Ata e ngritën lart. Nadiri ngriti duart dhe përshëndeti turmën e madhe të njerëzve që s'u bëhej të largoheshin nga salla. Pastaj i hodhi sytë nga karriget e para.

— Ikën me bishtin në shalë, — thirri një djalosh i gjatë, që po priste të përqafonte Nadirin.

— Arian, — thirri Nadiri i emocionuar. — Ku je, Arian! Të kam pasur ndër mend gjithë këto ditë, — dhe u hodh poshtë ta përqafonte.

— Sikur t'i ecte atij, do të zhvishesha dhe do të kapesha edhe unë me të, — tha i entuziazmuar Ariani.

— Po si munde të vish?

— Me lejen e komandantit. Pastaj s'kam ardhur vetëm, — dhe Ariani bëri me kokë nga njerëzit që po i buzëqeshnin.

Kur Nadiri, i shoqëruar nga mësuesi i fiskulturës, nga Fatmiri e nga shokët e tjerë po dilnin nga salla, përpara u doli nënë Fatimeja.

— S'më rrihej, — tha ajo me sy të përlotur, — s'më rrihej në shtëpi. — Dhe e puthi të birin. . .

RREMBIMI I BUZËQESHJES

Kur spikeri i përmendi emrin për t'u ngjitur në tapet, ai u drodh. Megjithëse, nga përmasat, tapeti ku u ngjit ishte i njëjtë me ato të dhjetëra tapeteve që kishte ngjitur në vendin e tij, prapëseprapë ju duk më i vogël. I bëhej se ai ishte vendosur lart dhe ishte mbështjellë me një tyl mjegulle të imët. Kur kundërshtari ju afrua tapetit, salla e madhe buçiti nga të thirrurat dashamirëse të spektatorëve, tifozë të tij. Ai u ngjit, përshëndeti sportdashësit, ju afrua Gjergjit dhe në gjuhën e vet i uroi suksese. Pastaj u kthye e shkoi në qoshen ku e priste treneri. Gjergji e peshoi mirë me sy kundërshtarin, sikur donte ta blinte me tërë ç'kishte. Ai vinte më i gjatë.

«Duhet ta mposht», — i dha kurajo vetes. Tani Gjergji nuk ja kishte frikën kundërshtarit. Atë e hutonte salla, salla e madhe që i dukej si një gojë e hapur, kur uturonte nga të thirrurat e sportdashësve. Ishte hera e parë që ngjitej në një tapet, i cili nuk ngrihej mbi truallin e vendit të vet. Ndaj e shihte sallën si me ankth. I bëhej se do të kishte përballë dy kundërshtarët: mundësin vendas dhe sallën. Dhe ashtu i emocionuar për një çast, i shkoi ndër mend se do të ishte salla ajo që mund ta mundte. Gjyqtari i tapetit e thirri në emër. Kjo e lehtësoi pak. Në sallë heshtje.

Emri «Albania» që shqiptoi shyqtari, kumboi në atë heshtje dhe i zgjoi sallës ca zëra entuziazte, që shpërthyen nga mesi i saj. Zërat si një kor i vogël, shpërndaheshin në të katër anët e sallës nga një megafon i fuqishëm. Sportdashësit e shumë vështronin me kureshtje grupin e vogël të studentëve shqiptarë, të cilët, të gëzuar, përshëndesnin Gjergjin, që përfaqësonte në këtë takim vendin e tyre. Gjergji i vështronte që nga tapeti. Sedra e tij u mbush me krenari dhe përgjegjësi. As dhe një herë nuk kishte provuar një përgjegjësi kaq të madhe për fatin e ndeshjes.

Gongu për fillimin e ndeshjes ra. Kur Gjergji, në mesin e tapetit, u gjend ballëpërballë me kundërshtarin, ju duk se ai ishte edhe më i gjatë nga ç'i ishte dukur në fillim.

«Do ta mposht, — i foli vetes përsëri, — trup me trup do ta mposht».

Kapjet e para ishin dhelparake dhe të matura. Gjergji donte ta mbërthente kundërshtarin me hyrje të drejta në bel, por kundërshtari mbrohej me duar, duke bërë çmos që t'ju shmangej lidhjeve të belit. Ai rrallë e tek provokonte kapjet e krahut. Dukej qartë se dhe ai ishte mjeshtër i luftimit trup me trup dhe se s'ja hante kollaj qeni shkopin. Ai qëndronte i mbledhur dhe i përkulur në gjunjë. Si ajo macja që mblidhet dhe përkulet kur do të kërcejë për të kapërcyer një mur të lartë, mbrohej e ju largohej me kujdes ndërhyrjeve të shpeshta. Rrallë e tek sulmonte. Por ndërhyrjet e tij ishin të shpejta e të papritura, posi ai breshëri që shpërthen nganjëherë në një ditë të ngrohtë vere. Ndërhyrjet dhe kapjet e tij, si me komandim, i ngrinin dhe i ulnin sportdashësit nga vendi, që nga çasti në çast shpërthenin në duartrokitje dhe të thirrura inkurajuese. Po dhe grupi i studen-

tëve shqiptarë nuk rrinte gjatë ulur. Ata, kur e mbërthente Gjergji kundërshtarin, shpërthenin me gjithë forcat e tyre. Gjergji që nga tapeti ua dëgjonte të thirrurat. Ato ja lehtësonin sadopak lodhjen.

Raundi i parë mbaroi. Ishte vështirë të dalloje se cili nga të dy mundësit kishte bërë më tepër kapje. Trainerët u jepnin këshillat e rastit mundësve të tyre. Minuta e pushimit mbaroi. Gongu dha sinjalin për fillimin e raundit të dytë. I pari sulmoi mundësi vendas. U duk qartë se treneri e kishte porositur që këtë radhë të ishte edhe më aktiv në sulm. Por tani kapjet e tij ishin më tepër të shpejta sesa të shkathëta. Por Gjergji, duke u treguar shumë i matur në mbrojtje, sprapste me burrëri ndërhyrjet e furishme të kundërshtarit, i cili ngulmonte vazhdimisht për të bërë kapje vendimtare. Me sa duket, atë e shqetësonte fakti që s'po i ecte si duhej me një mundës që për të s'ishte i dëgjuar. Mbrojtja e matur, dhe ajo që Gjergji herë-herë provokonte kapje të befasishme, kishte ngjallur interes dhe kureshtje për zhvillimin dhe fatin e ndeshjes.

Mundësi vendas, duke parë vendosmërinë e Gjergjit për një mbrojtje të mbyllur, nisi të përdorë dinakërinë. Ai linte gjoja si të harruar përpara krahun e majtë, me qëllim që t'ja kapte kundërshtari dhe ai në çast të kryente kundërkapjen. Dhe ja ku Gjergji ja kapi krahun dhe, pa i lënë rast kundërshtarit të kryente kundërkapjen, e tërhoqi pranë vetes e rrculloi nga ana e tij dhe, pasi e detyroi kundërshtarin të kthehej me shpinë, e mbërtheu mirë për beli dhe mendoi ta ngrinte lart, që ta hidhte në tapet nga prapa vetes. Por tek mundohej ta realizonte kapjen gjer në fund, mundësi vendas ja mbërtheu fort krahet dhe, duke ushtruar gjithë forcën e tij, ra përpara,

kaloj vetë në «gjysmë-urë» duke e detyruar Gjergjin të kalojë në pozicionin «urë», dhe të qëndrojë në këtë pozicion të vështirë për disa çaste. Tani mundësi vendas mundahej t'i peshonte sipër me tërë forcat e tij që ta ulte Gjergjin pak nga pak me shpatulla për tapet...

Spektatorët, si të dehur nga entuziazmi, të ngritur në këmbë thërrisnin dhe inkurajonin mundësin e tyre. Të gjithë qenë ngritur. Vetëm një copë vend dukej si i ngrënë. Grupi i studentëve kishte shtangur.

Në këtë çast të vështirë të ndeshjes, treneri, duke shtrënguar grushtat thirri:

— Gjergji! Jepi trupit nga e djathta, ashtu, përherë e nga e djathta...

Ai donte të vazhdonte, por ndërhyrja e gjyqtarit të tapetit e bëri të heshtë. Ndërkaq Gjergji i dha trupit nga e djathta e tij dhe kundërshtari, për të mos kaluar vetë në pozicionin «urë», i liroi krahun Gjergjit dhe brofi në këmbë. Po aq shpejt u ngrit dhe Gjergji. Në këto pak sekonda pushimi, Gjergji e mori veten dhe u mbush mirë me frymë.

— Gjergji! Sulmoje, patjetër sulmoje! — ishte zëri i shokut të tij në stolin pranë tapetit, i cili plotësoi atë që s'mundi ta thoshte treneri.

«Vërtet ashtu do të bëj», — mendoi Gjergji. dhe, kur gjyqtari i ftoi për t'u kapur, ai u sul mbi kundërshtarin, i cili me vështirësi ju largua sulmit të tij të shpejtë. Gjergji tani e kishte marrë veten dhe gjatë gjithë raundit u mundua të kryente kapjet me tërë forcat, që kështu kundërshtari të lodhej dhe të kishte pak energji për raundin e fundit. Më pas, ai dëgjoji disa herë tifozët që i thërrisnin mundësit të tyre të kundërvepronte, pasi tani ky kishte nisur më tepër

të mbrohej se sa të sulmonte. Dhe ja, kundërshtari mori prapë inisiativën për sulm. Por një kundërkapje e Gjergjit «krah-qafë» e shëmbi atë me një rën shpatull në tapet.

Mundësi vendas tentoi të ngrihej, po kapja e sigurtë e Gjergjit e detyroi të mbetej për disa çaste ashtu, dhe të kalonte pastaj me shumë mundim nga rënja me një rën shpatull në pozicionin «urë» e anasjelltas.

Gjergji mudohej ta mbante atë sa më gjatë në këtë pozicion të volitshëm për të dhe njëkohësisht ushtronte mbi trupin e kundërshtarit një forcë përherë e më të madhe, si për të shfryrë një duf që e mbyste përbrenda. Po akoma s'po mund ta vendoste me të dy shpatullat për tapet. Tani dhe mundësi vendas i kishte tendosur fort muskujt e qafës dhe me këmbë e duar mudohej që të mos arrinte deri atje sa t'i preknin të dyja shpatullat. Ky do të ishte një dëshpërim i madh për të, pasi prej disa vitesh, si kampion që ishte, nuk e kishte provuar shijen e një dëshpërimi të tillë. Ra gongu. Gjergjit dhe trainerit të tij ju duk se rënja e gongut ishte e parakohshme. Ishte si një aspirinë që ju dha për ta pirë mundësit vendas nga kronometristi kohëmbajtës, për ta shpëtuar nga një palë ethe të forta. Salla gumëzhinte nga pëshpëritjet. Tani studentët, të ngritur në këmbë, derdhën si një shatrivan entuziazmin e tyre në sallën e madhe, të mbushur nga mijëra sportdashës. Gjyqtarët me kureshtje shikonin herë te njeri mundës dhe herë te tjetri. Me sa duket, llogaritjet e pikëve nuk anonin vetëm te njeri. Ata donin të bindeshin, se kush nga të dy mundësit do t'i rezistonte më mirë dhe më shumë pjesës së fundit. Sallën e kapi ankthi për fatin e ndeshjes. Dhe ky qe një ankth pritës.

Gongu, si një kabanë që i ftonte të dy mundësit për fitore, ra. Gjergji u bë gati shpejt. Tani s'ja kish-te dhe aq frikën sallës. Traineri i pëshpëriti:

— Mbahu gjer në fund. Ashtu si na ka hije!

— Do të mbahem, patjetër që do të mbahem,
— u përgjegj shpejt Gjergji.


Raundi i fundit që si një ndeshje më vete. Spektatorët sikur i ngrinte dhe i ulte një dorë e madhe, e fuqishme, e padukshme. Të dy kundërshtarëve, të cilët ishin të denjë për njëri-tjetrin, u shndrisnin krahët nga djersa, siç i shndrit qimja kalit kur ka harbuar shumë. Raundi i fundit pothuajse vazhdoi me luftimin trup me trup. Mundësi vendas mundohej të përdorte shpejtësinë e kapjeve nga afër, por vrulli i Gjergjit e pengonte. Gjergji i futej midis krahëve të tij, si zjarrfiksi në mes të gjuhëve të flakëve, dhe pastaj, gjithë energji, shpërthente në kapje të forta e të herëpashershme mbi kundërshtarin, i cili nga fundi nisi më tepër të mbrohej sesa të sulmonte. Tani salla ngjante me një fidanishte, pemët e së cilës i anonte herë majtas e herë djathtas një fllad që frynte nga tapeti.

Në minutën e fundit të ndeshjes, Gjergji e kishte vënë përsëri poshtë kundërshtarin dhe, duke rënë ndër gjunjë, po matej t'i zbërthente krahët që të mund të kryente ndonjë kapje të saktë. Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Kundërshtari me një kërcim të bukur u largua shumë shpejt nga tapeti, duke e lënë Gjergjin si të habitur në pozicionin që ishte. Tani ishte mundësi vendas ai që qëndronte sipër dhe që tentonte të kapte. Vendet dhe rolet u ndërruan aq shpejt dhe aq papritur, sa që dhe gjyqtarët anësorë u ngritën dhe mbërthyen vështrimin në mesin e tapetit ku po zhvillohej çasti më vendimtar i krejt ndeshjes. Mun-

dësi vendas arriti ta ngrejë pak nga tapeti, t'i fuste krahët poshtë, t'i lidhte fort duart «kryq» dhe me një sforcim të madh ta ngrinte lart trupin e lodhur të Gjergjit, ta mbante ashtu të shkëputur për disa caste, si të deshte t'u thoshte tifozeve të tij: «Ja, nga cili krah doni që ta hedh» dhe e përplasi pastaj me inat për tapet. Gjergji ra me një shpatull dhe koka ju përplas për tapet. Piklat e djersës që kërcyen nga përplasja i ranë në buzë. Gjergji ndjeu shijen e kri-pur të djersës dhe nga inati i shtrëngoi dhëmbët.

«Shija e humbjes është edhe më e hidhur», — mendoi dhe në çast i përmbloodhi të gjitha forcat, brofi shpejt në këmbë, pa pritur që kundërshtari ta mbërthente në tapet dhe, pasi i tendosi mirë krahët, e ngriti rreptë vështrimin te kundërshtari, siç bën çdo njeri kur është përpara një prove të vështirë fizike, ja kapi krahët kundërshtarit me duart e tij dhe, pasi ja hapi anash, e mbërtheu për shpatullash, e ngriti lart, e rrotulloi nga e djathta e tij dhe e hodhi me gjoks për tapet.

Mundësi vendas, pasi e pa veten keq, duke u tërhequr me duar që t'i shmangej luftimit të ndershëm, doli jashtë tapetit. Gjyqtari i tapetit ndërhyri dhe i hoqi vërejtjen mundësit vendas për veprimin e padenjë që bëri. Dhe ja ku u dëgjua gongu. Spektatorët shtangën. Sytë e tyre nga të katër anët e sallës, posi prozhektorë të vegjël, hidhnin dritë habie, në qoshen ku qëndronte i lodhur por burrëror, Gjergji. Kundërshtari u ngrit nga tapeti me shpejtësi, si për t'ju larguar një vendi që i la një kujtim të hidhur. Gjergji u kthye. Traineri, duke i fshirë djersën, e përgëzoi. Ai i ra lehtas në krahë dhe Gjergji e kuptoi se fitorja i përkiste atij. Uli kokën për të fshehur gëzimin që ndjeu. Zemra i rrihte. Krahërori i ulej



dhe i ngrihej. Bashkë me të ngrihej e ulej dhe stema kuq e zi e Republikës që Gjergji e mbante të qepur në kanotierë. Studentët tani s'përmbaheshin dot. Të entuziazmuar, ata duartrockisnin dhe e hidhnin vështrimin herë nga salla e herë nga Gjergji, si të donin të thoshin: «Eh, e patë? Të këtillë jemi ne. Luftojme, qëndrojmë dhe në fund marrim dhe fitoren me vetë».

Ndërkaq spektatorët akoma nuk e kishin kapërcyer cakun e shtangjes. Si të donin të thoshin: «S'ta merrte mendja të tregohej kaq i fortë», ata e vështronin dhe e duartrokisnin mundësin shqiptar, që me duart e bashkuara lart përshëndeste grupin e vogël të studentëve dhe sportdashësit e tjerë. Herë-herë spektatorët tifozë të mundësit vendas kujtoheshin të shikonin mundësin e tyre. I shtangur në këmbë, duke pritur me dëshpërim vendimin e gjyqtarisë, ai vështronte dhe admironte Gjergjin, që në minutën e fundit i kishte rrëmbyer atij fitoren e bashkë me të dhe buzëqeshjen.

NJË NDODHI NË POLIGONIN USHTARAK

Kushtuar N. Hoxhës

Fillimi i pranverës. Kishim kohë që prisnim me padurim muajin e parë të kësaj stine. Në këtë muaj do të zhvillohej qitja me pushkë në bazë reparti. Megjithatë reparti ynë kishte armë speciale, ne prapë duhej të dinim të qëllonim mirë me pushkë. Për këtë arsye të gjithë ushtarët ishin përgatitur duke kryer shkollë shenjimi në stërvitje. Doli edhe urdhëri i ditës, ku thuhej se të nesërmen do të zhvillohej qitja në poligon. Natën s'na zuri gjumi. Ishim të shqetësuar. Qitja e nesërme kishte rëndësinë e vet. Në poligon do të vinim në provë aftësitë tona, njëkohësisht edhe krenarinë e repartit. Ndonjërin mund ta shqetësonte jo më shumë besimi në vetëvete sesa dëshira për t'u ndodhur disa ditë me leje pranë familjes në këtë zgjim të pranverës.

Mua m'u duk se i mbylla sytë i fundit për të fjetur. E dija se isha më i papërgatituri për qitjen e nesërme. Kisha munguar disa herë në stërvitjet e shkollës së shenjimit. Dhe kjo, se unë largohesha shpesh nga reparti për ndeshje sportive. Kur mbylla sytë, më slikoi ndër mend se s'do ta kisha dhe aq të vështirë të godisja në shenjë, po ta shtrëngoja fort qytën pas gropës së supit të djathtë dhe ta mbaja pak si gjatë fry-

mën. Pastaj «stërgjyshërit dhe prindërit tanë, mos kanë bërë shkollë shenjimi kur qëllonin armikun?» i dhashë kurajo vetes dhe më zuri gjumi.

E nesërmja erdhi. Xhamat po zbardhoheshin gjithnjë e sa më shumë. Të dukej se në drejtim të dritareve po afrohej dikush me një dritë të fuqishëm në dorë.

— Sot do të kemi kohë të bukur, ndaj duhet të na vejë mbarë në qitje, — më tha Agimi, shoku im më i afërt.

— Ashtu vërtet, — i thashë si pa qejf, — po, ama, për ata që janë përgatitur seriozisht.

— Ndoshta të ecën, — m'u përgjegj Agimi me ton të përzemërt. — E di ti se në qitje nganjëherë del më mirë kur je përgatitur më pakë. Ndoshta s'e kupton këtë, po kjo ka lidhje me emocionet.

Tunda lehtë kokën, si për t'i thënë: «Mund të ndodhë edhe kështu!»

Pasi bëmë gjimnastikën dhe hëngrëm mëngjezin, u nisëm. Poligoni dukej si një pishinë e cekët pa ujë. Një bar i hollë kishte mbirë në të. Të dukej se në poligon ishte shtruar një qylym i gjelbër, i punuar me lule deleje.

Nënoficer Gjeloşi ishte ngarkuar të drejtonte qitjen. Ai caktoi Agimin, shokun tim që ishte dhe piktor i repartit, të shkonte për të shikuar tabelat e shënimit, kur të fillonte qitja me bateri.

Agimi, përpara se të nisej të kryente detyrën që ju ngarkua, më hodhi një vështrim që zgjati për disa sekonda, si të donte të më thoshte: «E shikon se po të vete mbarë?»

Kur u shkrehën bateritë e para, të gjithë ushtarët i ranë në sup njëri-tjetrit. Nja njëzet metra larg nesh, mbi dheun që ishte nxjerrë kur ishte gërmuar

poligoni, u ul komandanti i repartit. Të gjithëve na shndritën sytë nga gëzimi. Komandanti, njeriu që ne e donim aq shumë, kishte ardhur të na shikonte. Nën-oficer Gjeloshi uli cepat e xhaketës për të rregulluar uniformën.

Unë u zura pak si ngushtë. Nuk doja të turpërohesha përpara komandantit. Këtë e ndjenin të gjithë ushtarët. Po mua më shqetësonte më tepër.

«Agimi, — mendova, — do të më ndihmojë disi që të mos turpërohem».

Qitja vazhdonte. Shpesh Agimi dilte nga gropa ku fshihej dhe kontrollonte tabelat e shpuara nga plumbat. Ai thoshte me zë të lartë pikët që kishin marrë ushtarët e çdo baterie. Komandanti shpesh buzëqeshte, bisedonte me oficerët që e kishin shoqëruar dhe pastaj shikonte nga ne duke prekur lehtë mustaqet. Së fundi u hidhte një sy tabelave. Dukej që gëzohej për ne, si për fëmijët e vet.

Më erdhi radha dhe mua. U shtriva dhe shtrëngova qytën fort pas gropëzës së supit të djathtë, mbajta gjatë frymën dhe shënova tabelën drejt e në pikën e zezë. U dëgjua zëri i nënoficerit:

— Zjarr!

Një breshëri plumbash dolën nga tytat e pushkëve tona në drejtim të tabelave. Pastaj edhe një tjetër, edhe një tjetër...

— Dreqi e marrtë, — hëngra inat me veten, — duhet të isha përgatitur si shokët

Ndërkaq Agimi doli nga gropa dhe ju drejtua tabelave. E dyta ishte imja. Zëri i tij erdhi te veshët tonë si i dridhur. Dukej se diçka e mundonte.

— Tabela e parë 26 pikë. E dyta 21...

Sakaq u dëgjua zëri i nënoficer Gjeloshit:

— Ushtar Agimi, nuk je duke thënë të vërtetën!

Unë ula kokën. Më erdhi turp nga vetja dhe keq për Agimin. Nënoficer Gjeloshi kishte të drejtë. Zëri i komandantit që ishte ngritur më këmbë, kumboi më i fortë dhe më i ashpër. Ai kishte një forcë të tillë, që pushtonte të gjithë poligonin.

— Ushtari thotë gjithmonë të vërtetën, shoku nën-oficer; por ushtari mund edhe të gabojë.

Një heshtje rrinte pezull mbi kokat e të gjithëve, si një pikëçuditëse e padukshme. Pas pak zëri i tij kumboi prapë, po këtë herë me ton urdhërues:

— Ushtar Adnani! Eja dhe ulu këtu pranë meje. Ushtar Agimi të kthehet e të qëndrojë pranë tabelave. Nënoficer Gjeloshi, vazhdo qitjen!

Unë tani u zura vërtetë ngushtë. Dhe ku se? Para shokëve të mi ushtarë, para oficerëve dhe, më e madhja, para komandantit tim. Në fillim s'm'u bë të shkoja drejt tij. Po ai kishte urdhëruar. Dhe fjala e tij s'ishte bërë kurrë dysh. Ndaj hodha hapat rëndë dhe ja ku u ndodha ballëpërballë me të:

— Ulu, — më tha pak si prerë, si për të treguar se e kishte harruar atë që ndodhi me mua pak më parë, dhe më bëri vend në krah.

U ula. Ishte e para herë që e ndjeja veten keq para tij. Shumë herë kisha biseduar e shkëmbyer mendime me të, sidomos për punë sporti. Ai e donte sportin dhe sportistët. Nuk linte ndeshje pa parë. Edhe vetë merej me fiskulturë, më shumë nga të gjithë oficerët e tjerë të repartit.

— Eh, — na thoshte nganjëherë duke qeshur, në fushën e volejbollit, — pilot u bëra dhe komandant më bënë, po ama, sportistë s'u bëra dot.

— Po ja, ju luani, shoku komandant, — i thoshim ne, — dhe luani mirë.

— E more, bëmani qejfin, ashtu siç ma bëni kur-

më vini kapiten skuadre. Po pse sport i thonë këtij? Këtij i thonë të dëfresh duke luajtur me top. Po, ama, për tifoz mos ma hani hakun. Për «Partizanin» vlej shumë.

Atëhere ne qeshnim e luanim më me qejf.

Po tani ishte krejt ndryshe puna. Më bëhej se isha ulur gabimisht pranë tij dhe se këtej e tutje s'do të kisha mundësi e kurajo të shkëmbeja me të goftë edhe një fjalë.

«Pse më thirri këtu, — mendoja. — Apo të më shohin më mirë ushtarët dhe oficerët?»

— Adnan! Kur po vije për këtu, dukeshe sikur sapo kishe mbaruar ndeshjen dhe kishe dalë prej saj i mundur, — më tha me atë zërin e tij të ngrohtë, duke më ftuar për një dialog miqësor.

— Të ishte ashtu, shoku komandant, do të qe më mirë për mua.

— Megjithatë duhej të kishe bërë më tepër shkollë shenjimi.

Unë mbeta i heshtur.

— Po, ama, dhe ne s'të kemi lënë kohë të stërvi-teshe me shokët. Adnan, na pregatit këtë skuadër; Adnan, na pregatit atë skuadër dhe ti s'na e prishje.

— Po ishte e thënë që t'jua prishja sot, shoku komandant.

Ai heshti për pak, pastaj, pa m'i shkëputur sytë, tha:

— Edhe ushtarëve s'u erdhi mirë.

— Me ata rregullohem. Qitja e ardhshme do të vonojë ca, po do të vijë patjetër.

— Atëhere do të më bësh dhe mua ta haroj këtë. Po prit një herë. Unë të jam borxhli. Në ndeshjen e spartakiadës ti dole i pari. Na nderove të gjithëve. Dhe unë akoma s'të kam shpërblyer.

— Ajo iku, shoku komandant.
— Jo, s'ka ikur. Do të shkosh ca ditë me leje.
— Këtë s'e meritoj, shoku komandant, — thashë me zë të mbytur.

— Po të mos e meritoje, s'do të ta jepja.
— Nuk dua që ndër shokët e mi ushtarë të ketë ndonjë pëshpëritje për ju. Ata kurrë s'e kanë bërë këtë.

— Se i kam si fëmijët e mi.

— Ashtu është.

— Ndaj dhe duhet të më dëgjosh e të më bindesh. Nesër do të dalësh në urdhërin e ditës.

U turbullova. Mos vallë ai kujtonte se unë e kam shtyrë Agimin të bënte gabimin që bëri? Dhe përse? Se unë paskam dashur të shkoj ca ditë me leje! Jo, kjo nuk ishte e vërtetë. Mos ishte për krenarinë e repartit? Kjo ndoshta. Oh, jo, dhe kjo s'duhej. Ej, Agim, Agim, pse e bëre këtë?!

— Jo, shoku komandant. Nuk do të largohem nga reparti. Do të qëndroj këtu të përgatitem. S'do t'ju turpëroj si sot. Atëhere do të mendoni më ndryshe për mua.

Dhe ja ku ndjeva krahun e tij të pushojë mbi supet e mi dhe njëkohësisht ndjeva se unë isha ushtari më i lumtur.

Pas pak dëgjova zërin e tij të fortë e kumbues:

— Nënoficer Gjeloshi! Vazhdoni qitjen. Mos u dehni nga sukseset.

Nënoficer Gjeloshi i buzëqeshi lehtë, sikur me të donte të thoshte: «Jo, shoku komandant. Nuk është kjo arësyeja. Unë e ndalova zjarrin, sepse ushtarët duan që t'i shikosh», — dhe, pasi uli prapa cepat e xhakëtës ushtarake, mori drejtqëndrim dhe urdhëroi:

— Zjarr!

NE PRAK TË HAKMARRJES

S'kishte shumë që Xhejp Dingu ishte futur në sallën e pritjes së spitalit, dhe megjithatë, i bëhej se kishte shumë kohë që qëndronte duke pritur. Megjithëse e dinte që infermierja e shërbimit do ta lajmëronte për ardhjen e Xhoes, ai prapë që ngritur disa herë dhe, me duar në xhepa, kishte qëndruar në këmbë pranë dritares që shihte nga rruga. Një herë u bë gati t'i binte numrit të telefonit të shtëpisë së vet dhe të pyes- te në se Xhoe kishte ardhur për të marrë veturën. Por jo. Ai s'mund ta bënte këtë. Gruaja dhe fëmijët s'duhej ta dinin që po dilte nga spitali. Vetëm Xhoe; shoku i tij më i afërt, duhej ta dinte. Dhe ai vetëm kaq.

Në rrugë u dëgjua zhurma e një makine që ndaloi te porta e spitalit. Po, Xhoe kishte ardhur. Xhejp Dingu përshëndeti infermierën, zbriti me nxitim shkallët dhe shpejtoi të dalë në rrugë.

— Hello, Xhoe! — përshëndeti me dorë shokun që po i afrohej.

— Hello, Ding! — dhe të dy shokët e vjetër shtrënguan duart miqësisht.

— Vonë, Xhoe...

— Vërtet, po s'e kisha të lehtë të merrja veturën. Gruaja dhe fëmijët më rrethuan. Duhet t'u thoshë diçka.

— Dyshuan? — pyeti Dingu duke i vënë dorën në sup, si për t'i thënë: «Të lutem përgjigju drejt për këtë».

— Jo, Ding. Kur bëra të dal, më përcollën gjer në rrugë dhe buzëqeshja s'u ndahej nga buzët, si-domos fëmijëve.

Krahu i shtrirë u tendos dhe Xhoe ndjeu gish-trinjhtë e fortë të Dingtut të shtrëngohen.

— Shkojmë, Xhoe. Drejtoje ti. Sot sikur s'më bëjnë duart për timon.

U futën në veturën e zezë dhe ndenjën në krah të njëri-tjetrit.

— Si shpejt, Ding. Të rrije akoma s'do të ishte keq. — Xhoe i tha këto fjalë i matur, i shtyrë nga përshtypja që i bëri fytyra pa jetë e shokut.

— S'e shtyja dot kohën, — tha shpejt Dingu. — E kisha shumë të vështirë të qëndroja gjatë i shtrirë, duke e pasur kraharorin të veshur me allçi. Oh, Xhoe, më kupton! Si i paralizuar, Xhoe. . . keq, shumë keq. . .

Tjetri, si për të larguar dëshpërimin e shokut, i dha gazit edhe vetura u nis mengadalë.

— Ti, Xhoe, më mirë se kushdo e kupton se atje çdo orë ishte për mua si ora e vdekjes. Më vinte rëndë, shumë rëndë nga të gjithë kur më shikonin ashtu. . . Të ishte diçka aksidentale, do të ishte ndryshe, por. . . Më shpejt, Xhoe, më shpejt. Vetëm të vdekurit shkojnë kaq ngadalë.

— Të kishe qëndruar dhe ca, Ding. Duhet të shëroheshe plotësisht.

— E përse! . . . Hajde, më shpejt, Xhoe, më shpejt.

Tjetri shtrëngoi rrethin e timonin dhe s'i vinte mirë që shoku i tij kishte dalë nga spitali më shpejt nga ç'duhej.

— Freskohemi me ndonjë pije, Ding — e ftoi si të qe i bindur se, duke pirë diçka, shoku do ta ndjente veten më të qetë.

— Mirë, Xhoe, po ama larg zhurmës së qytetit. Vetura tani shkonte me shpejtësi. Të dy shokët i kishin mbërthyer sytë te xhami. Xhoe mundohej të përqëndrohej. Ai kishte timonin dhe dinte mirë se ç'do të thoshte: «të mbash timonin në rrugët e çmëndura të Çikagos». Po mendja i punonte për Dingun, shokun e tij të afërt. Dhe më parë kishte menduar për fatkeqësinë e tij, dhe atëhere i thoshte mendja se, sapo të dilte Dingu nga spitali i shëruar, do ta merrte prapë veten, do të fillonte stërvitjen e do të shkëlqente prapë në ringun profesionist. Po tani i doli ndryshe. Shoku i tij e merr në telefon dhe i thotë me kokëfortësi se ka vendosur të dalë nga spitali. Ç'e shtyn vallë?! Ja, shikon, ka ngrirë si një bust! Dhe Xhoe ktheu kokën dhe pa shokun e tij.

«Ç'të ketë? — mendoj dhe e ktheu prapë kokën përpara. — Ndoshta dëshpërimi për humbjen e ndeshjes me Tomin! Veç Dingu është burrë i fuqishëm dhe i rritur me dorezat e boksit ndër duar, ndaj ai e di mirë se nuk fitohet gjithnjë...»

— Jeta qënka si një ndeshje, Xhoe, tamam si një ndeshje, dhe që ta fitosh duhet të godasësh e të godasësh... — Dingu foli aq lehtë, sa Xhoes ju duk se shoku i tij po fliste përçart.

— Po, Xhoe, ashtu. S'duhet të ankohem. Mua më eci. Së bashku e nisëm, po ishte e thënë që unë të godas më tepër dhe të fitoj më shumë. — Ai foli lehtë, pa ja ndarë sytë xhamit të përparmë. Pastaj heshti, sikur të qe penduar për ato që tha. Pas pak ja dha të qeshurit: — Ha, ha, ha... M'ister Klarku! Me siguri ashtu të ka thënë edhe ty: do të të mësoj të godasësh

mirë, shpejt, fort. . . Pastaj do të bëhesh kampion, do të bëhesh i madh dhe do të vijë një ditë që ti do të më falëndërosh me gjithë zemër për këtë të mirë... Eh, Mister Klark, mister Klark! Ja, dita erdhi!

Xhoe ngadalësoi shpejtësinë dhe pa Dingun, «Shtangja e tij, — mendoj, — s'është shenjë e mirë. — Dhe u mundua t'i kuptonte më drejtë fjalët. — Ai është i sigurtë se mister Klarku më kishte thënë mua ashtu. Kurse që ndryshe. Fjalët e fundit ai ja kishte thënë vetëm Dingut».

— Qëndrojmë këtu, Ding, — tha ai pas pak.

Dingu u kthye dhe, në vend të aprovimit, i hodhi Xhoes një shikim keqardhës, si për t'i thënë: «E, ç'jem i ne, Xhoe?! «Pastaj si t'i shpikëj në mendje diçka tjetër, u kthye, shtyu me forcë derën e kërceu në trotuar.

— Eja, Xhoe, mos të humbasim rastin të pimë për mister Klarkun që na bëri të mëdhenj. . .

Xhoe zbriti nga vetura dhe, si fëmia që lodh mendjen për të gjetur një gjëzë të vështirë, vriste trurin për të shpjeguar enigmën shqetësuese të Dingut. Në fillim ai kishte gjykuar se goditjet e vrullshme e të forta të Tomit e shembën Dingun keqas në tapetin e ringut. Dhe pastaj? Prej atëj në spital. Po ky ishte vetëm një gjykim i thjeshtë. Jo, dëshpërimi i shokut të tij nuk rridhte nga humbja tragjike me Tomin. Për të gjithë ata që e panë ndeshjen, dhe për ata që e dëgjuan më pas, kjo ishte një e papritur e madhe, se Dingu kishte arritur lulëzimin e shkathtësisë dhe të forcës së tij dhe, pas shumë ndeshjesh të bëra, akoma s'e kish provuar shijen e humbjes. Për Tomin e ri kjo do të ishte një ndeshje e vështirë. Po sporti ka të papriturat e veta dhe e jashtëzakonshmja, pasi shihet e dëgjohet, s'është më e jashtëzakonshme. Tani në gjithë

qytetin flitet se Dingut, sapo të dalë nga spitali, do t'i mjaftojnë forcat që ka për ta ngritur prapë lart dinjitetin e vet.

— Ej, Xhoe! Ç'më vështron ashtu sikur jam hiçgjë, siç mund të jetë vetëm hija, kufoma e Xhejp Dingut?

— O, Ding, kështu jo. Ne jemi shokë. Nuk bën të flasësh kështu. Vërtet që mendja më bluan diçka. Po prapë këtë e lidh me Tomin. Mos ndoshta ngule këmbë të dilje nga spitali, se nuk të pritej sa të fillosh stërvitjen e t'i marësh Tomit revanshin?

— Po, Xhoe! Mezi po pres sa të takohem me mister Klarkun.

— S'do ta kemi të lehtë. Ka ditë që s'është parë në sallën kryesore të stërvitjes. Thonë se është dëshpëruar shumë për shkak të fitores së Tomit.

— Njerëzit e thjeshtë gënjehen, Xhoe. Hajde, ngrije ta pimë një gotë për takimin tim të shpejtë me mister Klarkun.

Tjetri donte të fliste dhe i dukej e lehtë ta kundërshtonte shokun e tij, por s'ishte ashtu. «Ç'thotë Dingu kështu? Ai flet dhe me ato çka thotë, po më çorodit përherë e më tepër. Ku do ta nxjerrë? Pastaj pse m'u lut ta mbaj të fshehtë daljen e tij nga spitali e, për më tepër, për gruan e fëmijët!»

— Ata që mbushin sallat dhe të tjerët që na shohin në ekranin e televizorit, thonë për ne fjalë nga më të ndryshmet: se jemi të guximshëm, të shkathët, të fuqishëm, gjakftohtë, që priremi nga reflekse të habitshme, që gjykojmë shpejt e drejt dhe që me këmbët e duart tona të fuqishme ngrejmë lartë krenarinë e kombit dhe famën e vetëvetes. Kurse ne...

— Ku do të dalësh me këtë, Ding? Ndaj meje ti mban një të fshehtë.

— Ashtu ka qenë. Por s'e kisha unë në dorë. Më urdhëruan. Dhe unë heshta.

— Dhe për tani të kanë urdhëruar?

Dingu uli kokën dhe shtrëngoi gotën e uiskut, si të donte ta thërmonte në pëllëmbën e vet. Pastaj e ngriti kokën si me përtim dhe pyeti:

— Si të është dukur mister Klarku, Xhoe?

— Njeri që është bërë skllav i pasionit të tij.

— Skllav i marrë pas dollarit!

— Aq sa unë e ti.

— Pse thua kështu, Xhoe?

— Se e njohim të dy prej kaq vjetësh.

— Lëri vjetët, Xhoe. Ata janë si grushtat e fortë që na godasin në ndeshjen e jetës dhe që na bëjnë të shembemi më në fund përtokë. Më fol për mister Klarkun, a është i ndershëm si unë e ti?

— Nuk e di, nuk e di, po në ndeshjen me Simeonin! — ti e mban mend mirë atë ndeshje të fortë, — kur munda të fitoj vetëm në të trembëdhjetin ... si t'u duk?

Dingu pohoi me kokë duke mos ja ndarë sytë për asnjë çast Xhoes.

— Atëhere Simeoni u çua në vetull në të shtatin. Në pushimin e të tetit, mister Klarku më porositi t'i shmangesha më shpejt së djathtës së fortë të Simeonit dhe të vazhdoja të godisja me të majtën time. S'e di pse, por çova sytë dhe e pyeta shpejt: ku ta godas në vetullën e çarë? Jo, Xhoe i mirë, më tha, jo në vetullën e çarë po pak më poshtë, në drejtim të nofullës.

Dingu përplasi gotën e uiskut në dyshemenë e mermertë dhe u çua shpejt nga karrigja i nevrikosur. Ça vështrime habie u kthyen nga tavolinat e tyre, në mesin e verandës, po kamerieri shpejtoi dhe, pasi paguan, shkuan dhe u ulën prapë në sediljet e buta të

veturës. Tani Xhoe qe habitur dhe s'dinte ç'rrugë t'u jepte mendimeve që i shponin trurin.

— Ç'njeri ky mister Klarku! — tha si me vete Dingu, kur vetura përshkoi me shpejtësi kilometrat e parë në rrugën e kthimit për në qytet. — Pas ndeshjes me Xhejmsin e moshuar, në dhomë hyri me nxitim Bek Kingu, afaristi ynë. Aty qe dhe mister Klarku. Beku më uroi për fitoren që kisha korrur dhe, pasi u mendua një copë herë, më tha me ton ngulmonjës.

— Shiko, Ding. Me këtë shpirtmadhësinë tënde do ta pësosh dhe do të na marrësh më qafë. . .

Kur shkoi Beku, unë ula kokën i menduar pranë gjunjëve. Beku deri diku kishte të drejtë. Vërtet që në të dhjetin e kisha futur Xhejmsin e lodhur në qoshe dhe e kisha fare të zbuluar. Ju afrova dhe e godita në të majtë, në ballë. Ai bëri pak prapa dhe erdhi e u pështet te supi im. Isha i bindur se, po ta goditja prapë, Xhejmsi do të shembej keq përtokë. Unë në të gjitha raundet e kisha vënë përpara atë dhe, nga kjo ai ishte shumë larg fitores. Atëhere ndjeva mister Klarkun të më thotë:

— Ding! Beku ynë harron se ne jemi së pari njerëz, se kemi logjikë, se kemi zemër. . .

— Mister Klarku është babaxhan njeri.

— Jo ashtu, Xhoe, mos ashtu! — dhe Dingu përplasi grushtin në derë.

— Po Ding, mister Klarku ka qenë për mua një baba i dytë.

— Dhe në mos qoftë ashtu, Xhoe, do ta paguajnë shtrenjtë, desha të them, se do ta paguajë shumë shtrenjtë.

Xhoe e ngadalësoi shpejtësinë dhe ja hodhi sytë

tërë ankth shokut në krah. Pastaj frenoi dhe foli vrazhdë:

— Mister Ding! Prej shumë vjetësh kemi qenë shokë. Po ja që s'paskemi qenë shokë, — dhe Xhoe hapi derën e kërceu në rrugë.

Dingu e pa një herë me respekt shokun e fëmijërisë, pataj u hodh në sediljen pranë timonit, e ngau veturën mengadalë gjersa la prapa Xhoen dhe pastaj i dha me të shpejtë. I erdhi keq që po humbiste një shok të vërtetë, siç qe Xhoe, po e ngushëlloi veten duke thënë: «O Xhoe i mirë! Tani unë s'do të të duhem më». Dhe instiktivisht e çoi mendjen te gruaja e te fëmijët. Jo, jo! — thirri me vete. — Tani s'i duhem më asnjëriut!

Sapo mbërriti në qytet, Dingu e ndaloi veturën para dyqanit ku shiteshin armë. U fut me nxitim brenda, kërkoi një revolver, pagoi dhe hipi po me nxitim në veturë. E ktheu nga e djathta dhe pas disa minutash e ndaloi maqinën para shtëpisë së mister Klarkut. Zbriti, i ra ziles disa herë dhe, për fat, në shkallë u duk vetë mister Klarku. Kur pa Dingu te dera, ai u step, si njeriu që nuk di ç'të bëjë. Pastaj e përmbloodhi veten dhe, me një buzëqeshje të mekur ndër buzët, shpejtoi, hapi derën dhe, pasi u përshëndet me Dingu, e ftoi të futej brenda.

— Faleminderit, mister Klark, po s'kam shumë kohë në dispozicion. Do t'ju lutesha të dilnim së bashku!

Mister Klarku tundi kokën lehtë, si për t'i thënë: «Për këtë s'duhet lutje, i dashur Ding!» Dhe, pasi mbylli derën, u afrua dhe u fut në veturë, e cila, sikur ta kishin shtyrë me forcë nga pas, bëri shpejt përpara.

Ndërkohë mister Klarku nxori nga xhepi i jele-

kut puron dhe i rënë në mendime nisi të tymosë. Ndërkaq Dingu vështronte vetëm përpara. Pastaj mister Klarku foli me zë të qetë dhe të matur:

— Nuk më erdhi mirë që s'më pranove për vizitë.

— Edhe gruan e fëmijët s'i lejova të më shikonin. Ashtu i shtrirë dhe i ngrirë në allçi, më vinte të haja veten me dhëmbë.

Mister Klarku me lëvizje të pavullnetshme u kthye ngadalë, pa fytyrën nervoze të boksierit të tij, tundi disa herë kokën lehtë, si për të thënë: «S'ke bërë mirë që ke vepruar kështu», — dhe kafshoi fundin e puros.

— Megjithëse unë isha i shtrirë, disa vazhdonin akoma të fitonin në saje të legjendave të poshtëra që thurnin në kurrizin tim

Mister Klarku s'e luajti fare kokën dhe s'i dha përgjegje. Shikonte vetëm përpara, si për të thënë: «Tani s'më intereson më se kush është i poshtër dhe kush është i mjerë».

— Gazetat dhe revistat i mbushën faqet kur Tomi u largua nga spitali i fyer.

Mister Klarku përsëri s'e luajti fare kokën, si për të thënë: «Tani pak më intereson se kush shkruan e kush nuk shkruan, kush fiton e kush humbet».

— Mirë, mister Klark, — dhe Dingu e ngriti zërin. — Po tani do të përgjigjesh?

Tjetri u kthye mengadalë dhe tundi prapë kokën, si për t'i thënë: «S'bëre mirë që e ngrite zërin kështu!»

Vetura e uli fare shpejtësinë dhe, sikur t'i qe mbaruar benzina, u ndal në krye të rrugës.

— Mister Klark! Xhoe thoshte se ju jeni njeri i ndershëm dhe ai të ka si baba të dytë. Të pyes, pra,

për Xhoen e mirë: e dinte njeri tjetër, përveç meje, teje dhe Tomit shembjen time në brinjë?

Mister Klarku shtrëngoi puron, puliti sytë dhe si me turp ktheu përsëri kokën përpara.

— Mister Klark, — dhe Dingu futi dorën në xhep e kapi revolverin. — Të pyes përsëri në emër të Xhoes së mirë. Përse nuk bëre çmos të shtyhej ndeshja, kur unë të erdha dhe të kërkova me këmbëngulje që ajo të shtyhej? Ti e dije mirë që unë gjatë stërvitjeve të fundit shemba keq dy brinjë në anën e majtë. Përse ngule këmbë që të mos shkoja te mjeku?

Mister Klarku uli kokën mbi kraharor si për të pohuar: «Po, unë e dija që gjatë stërvitjes ti kishe shembur keq të dy brinjët e anës së majtë».

— Po atëhere, mister Klark? — briti Dingu dhe nxorri dorën nga xhepi.


Mister Klarku, me lëvizje të ngathëta, futi dorën në xhep dhe pa kujdes nxori revolverin e tij e ja hodhi Dingu përpara, si për t'i thënë: «Na, merre edhe timen».

Dingu liroi gishtin nga këmbëza dhe e la revolverin t'i varej në gishtin tregues. Pastaj e zgjati dorën dhe, mengadalë, la revolverin e tij pranë tjetrit.

— Të lutem fol, Mister Klark, dhe unë të kam pasur në vend të babait, si Xhoe i mirë!

— Tek shikoja Tomin që sulmonte me ngulm dhe të godiste po në anën e majtë, te brinjët që ti mundoheshe t'i mbroje, më vinte keq për ty, Dingu, dhe mallëkoja e urreja çdo çast veten.

Tek qëndronte ashtu me sy të ngrirë, duke vështruar përherë përpara, mister Klarku s'kuptohej në i fliste vetes, apo dikujt tjetër.



— Kisha dëgjuar që njerëz si Bek Kingu e duan dollarin më tepër edhe se burrinë, se besën, se nderin. . . Po pse, ne s'ja mbushnim vallë xhepat? C'donte tjetër?!.. Pastaj ti duhet ta dije, Ding, që kontratën për ndeshje s'mund ta anulloja e ta shtyja unë. Atë gjë e kishte në dorë vetëm Beku. T'u luta që kurkujt të mos ja zije në gojë shembjen e brinjëve, as Xhoes. Këtë gjë e kërkonte ligji i rreptë i boksit profesionist. Dhe unë ju luta Bekut për shtytjen e ndeshjes. I tregova gjithshka që ai ta shtynte ndeshjen dhe fundja të prishej kontrata. Po Beku nuk e shtyu ndeshjen. Beku. . . Ah, Ding! E përse të jetë kaq i poshtër njeriu?!

Dingu përmbloodhi veten dhe shtrëngoi grushtat fort.

— Vërtet! — murmuriti nëpër dhëmbë. — Ç'donte më tepër? — dhe, i mbushur me një urrejtje të madhe, shtriu krahun dhe mori revolverin e tij.

Mister Klarku, si të mos qe çliruar akoma nga ankthi që e mundonte, shtriu dhe ai krahun dhe në mënyrë krejt të pavetëdijshme mori revolverin që kishte mbetur dhe me ngathtësi e futi në xhep.

«Ky vuan, siç vuaj edhe unë», — mendoi Dingu që kishte ndjekur me sy veprimin e mister Klarkut, dhe, si të donte ta hiqte sa më shpejt nga vetja ankthin torturonjës, luajti marshet dhe i mëshoi fort gazit. . .

— Të tjerë duhen vrrarë!

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

— Libra të reja —

Besnikëria e një qeni
Karabina
Qyteti ynë
Kallinjtë e artë
Tregimi i gjyshes Marë
Unë pionieri
Gëzim për të gjithë
Kur erdhi pranvera
Në gjiun e kaltër të Jonit
Shqiponja e Vermoshit

Ivoni Reso
Jonus Dini
Spiro Xhaji
Klementina Qesko
Dhimitër Karaguni
Pandeli Koçi
Kostandin Leli
Namik Dokle
Thanas Peçi
Vehbi Skënderi

Çmimi: Lekë 1.50